



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional**

**“Drejtimi i SME-ve”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Artur Ribaj

2. PhD Eriona Shtëmbari

Prill / 2020

# PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës

Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD) është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20 dhjetor 2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës". Për herë të parë Universiteti Aleksandër Moisiu i hapi dyert në tetor të vitit 2006 dhe në bankat e tij u ulën rreth një mijë student kryesisht nga prefektura e Durrësit dhe qytetet e tjera të Shqipërisë.

Fakulteti i Biznesit (FB) është një nga tre njësitë kryesore të UAMD, i cili mori këtë emër nga riorganizimi i universitetit bazuar në VKM-në Nr. 685, datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e UAMD". Ky fakultet në gjithë veprimtarinë e tij synon të arrijë standarde akademike bashkëkohore në rrangun kombëtar, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore të cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë në një mjedis inkurajues dhe mirëpritës.

UAMD evidenton si element dallues edhe faktin që diplomat e tyre ofrohen në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe notat shprehen në tri sisteme (shqiptar, amerikan dhe ai evropian i Kartës së Bolonjës) për të krijuar lehtësi lexueshmërie, transferimi dhe vazhdimi të studimeve pasuniversitare në universitetet e tjera shqiptare, europiane dhe amerikane.

Departamenti i Menaxhimit është një prej pesë njësitë bazë të Fakultetit të Biznesit, i cili ka katërmëdhjetë (14) anëtarë PAE dhe gjashtë (6) anëtarë PAK, në përbërjen e tij për vitin akademik 2019-2020. Ky departament është njësi bazë që ka përgjegjësinë të ofroj programin e studimit Master Profesional në "Drejtimit i SME-ve" i cili synon arsimimin profesional të studentëve në fushën e drejtimit të biznesit të vogël dhe të mesëm. Programi Master Profesional në "Drejtimit i SME-ve" është unik në llojin e tij duke sjellë një rol të veçantë në përgatitjen e studentëve për tu bërë ekspertë të denjë në krijimin dhe Drejtimin e SME-ve, mbijetesën dhe rritjen e tyre si shtylla kurrizore e ekonomisë së Shqipërisë.

Programi i studimit Master Profesional "Drejtimit i SME-ve" është hapur me vendimin nr.1161, datë 25.11.2009 për hapjen e programeve të studimit "Master i Niveli të Parë", në universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës dhe më pas është riorganizuar me vendim senati Nr.105, datë 14.06.2018 nën masën 20 % , vendim i cili është miratuar nga MASR me shkësë Nr. 7243/1 Prot., datë 22.08.2018.

Ky program gjatë viteve të fundit ka pasur përgjithësisht një trend pozitiv rritës për numrin e studentëve që kanë përzgjedhur këtë MP në preferencat e tyre pavarësisht se në përfundim trendi i rregjistrimit ka qenë rënës. Pavarësisht ideve, planeve dhe përpjekjeve të bëra mund të konstatohet se njësi bazë, njësi kryesore dhe drejtimi i IAL-së duhet të zhvillojnë strategjitë e duhura për rekrutimin dhe mbajtjen e PAE cilësor dhe të mjaftueshëm për zhvillimin e lëndëve dhe syllabullave të përshtatur me nevojat e tregut dhe praktikave më të mira në "Drejtimit i SME-ve". Ndërsa Senati dhe Bordi Drejtues i IAL duhet të kërkojë që KPGSCI dhe NJSBC të sigurojnë kryerjen e funksioneve të veta me pavarësi, profesionalizëm dhe transparencë ndaj gjithë pretendentëve.

Për tu evidentuar është vëmendja që pedagogët dhe strukturat drejtuese i kushton studentit në trajtimin e shqetësimeve të tyre, si edhe angazhimin e tyre në projekte, trajnime, dhe praktikë. Gjithashtu, nëpërmjet një mjedisi universitar tërësisht me ambiente të reja dhe me facilitetet e duhura, studentët kanë mundësi të ndihen në kushte komode për zhvillimin e mësimin dhe përgatitjen e tyre profesionale.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Mbështetur në VKM nr. 109 ASCAL ka percaktuar kohen dhe grupet e vlerësimit. Gjithashtu ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm me Urdher nr. 53, dt. 18.06.2019, për akreditimin e programit Master Profesional në “Drejtimi i SME-ve”. Grupi i jashtëm i vlerësimit përbëhet si më poshtë:

1. Prof. Asoc. Dr. Artur Ribaj;
2. PhD. Eriona Shtëmbari;
3. Msc.Erjon Xhako, Koordinator teknik i ASCAL.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ky dokumentacion pati disa mangësi të cilat u kërkuan të plotësohen nga ekspertët para se ata të shkonin për vizitë.

Ekspertët përgatitën draft vlerësimit shoqëruar me pyetjet për pjesët që kërkonin qartësim të mëtejshëm dhe/ose verifikim të cilat u kryen gjatë vizitës në IAL në datat 13-14 Janar, 2020. Gjatë ditëve të vizitave në IAL u kryen diskutimeve intensive dhe proaktive mes GVJ dhe drejtuesve, pedagogëve, anëtarëve të GVB-së, studentëve, stafit administrative, etj. Dokumentacioni shtesë i kërkuar pas vizitës në IAL nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 20 Janar, 2020 përmes sistemit të ASCAL.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave, komenteve për draft DVV, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për cdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master Profesional “Drejtimi i SME-ve”. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analize mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Draft raporti i vlerësimit të jashtëm u dërgua në institucion me anë të sistemit AMS më datë 26.03.2020 dhe me shkresë zyrtare Nr.4/38 Prot. Institucioni ka përcjellë komentet mbi draft raportin me anë të sistemit AMS më datë 02.04.2020. *Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL, për dërgimin e draft raportit dhe raportit të vlerësimit të jashtëm është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 datë 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.*

GVB në përgjigjen e tyre të dërguar më datë 02.04.2020 shprehet se: *“GVB në MP Drejtimi i SME-ve, që në zanafillën e krijimit dhe nisjes së punës së këtij grupi, e vlerësoi Akreditimin e Programit MP Drejtimi i SME-ve si një proces në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. GVB-ja gjykoj se, me mbledhjen e dokumentacionit, analizimin e tyre, hartimin e raportit (RVB) dhe me vizitën e GVJ në IAL, ka nevojë për refleksione, të cilat duhen përmirësuar në përsosjen e standarteve. GVB-ja e falenderon GVJ që ishin e pjesë e këtij procesi dhe i vlerëson anëtarët e saj për profesionalizmin dhe serizitetin e treguar...”*. Në vijim GVB paraqet komentet e tyre për disa prej kriterëve në fushat e RVJ-së.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit vlerëson angazhimin e tyre të menjëhershëm në adresimin e disa prej gjetjeve të konstatuara nga GVJ, megjithatë ato do të jenë subjekt vlerësimi në akreditimin e ardhshëm. GVJ lidhur me komentet e dërguara nga GVB sqarojmë si vijon:

- **Fusha II. Standarti II.2. Kriteri 1.**



### Konstatimi i GVJ:

- (1) “Në RVB por edhe gjatë vizitës në IAL nuk u evidentua që Departamenti i Menaxhimit të jetë i organizuar në grupe mësimore me karakter kërkimor sipas (L. 80/2015 - Neni 25, pika 5).
- (2) Numri i PAE të angazhuar në programin MP “Menaxhimi Biznes” nuk ka plotësisht përputhje me detyrimet në fuqi (L. 80/2015 - Neni 25, pika 4), pasi ka pedagog pa grada shkencore që janë të angazhuar në mësimdhënie në këtë program gjatë 3 viteve të fundit.”

### Komenti i GVB:

- (1) *GVB nuk bie dakord me konstatimin e GVJ-s se Departamenti i Menaxhimit nuk është organizuar në grupe mësimore me karakter kërkimor, pasi Departamenti i Menaxhimit është i ndarë në dy grupe mësimore me karakter shkencor. Grupet janë emërtuar si në vijim: (1) për grupin e lëndëve “Menaxhim” me drejtues të këtij grupi është Prof. Asoc. Dr. Ulpian Hoti dhe (2) për grupin e lëndëve “Organizim drejtim biznesi” me drejtues të këtij grupi është Prof. Asoc. Dr. Bajram Korsita. Këto argumenta mbështet në evidencën nr. 106 “Vendimi për Koordinatorët e programeve”.*
- (2) *GVB citon se, ashtu sikurse citoj gjatë takimit, angazhime të tilla kanë ardhur si rrjedhojë e zhvillimit të institucionit dhe marrjes së gradës nga PAE. Njëkohësisht, edhe të pritjes së daljes së akteve të tjera nënligjore. Megjithatë, kjo është reflektuar duke u aktivizuar tashmë, në vitin aktual akademik dhe në vazhdimësi PAE/PAK, të paktën me gradë shkencore (orari për vitin akademik 2019-2020).*

**GVJ:** Raporti për pikën (1) **ndryshon**, pavarësisht se argumenti i sjellë sot duhet të ishte i pasqyruar në RVB si edhe cituar gjatë takimit.

Raporti për pikën (2) **nuk ndryshon**, pavarësisht se mund të jenë marr masat. Këto masa të marra tani do të verifikohen dhe do të shërbejnë akreditimit të rradhës tjetër.

- **Fusha II Standarti II.2 Kriteri 2-5.**

### Konstatimi i GVJ:

“GVJ citon në brendësi të shpjegimit të këtyre kriterëve, se:

- (1) u kërkuan të dërgohen evidenca të analizave dhe diskutimeve të bëra në njësinë bazë për shpërndarjen e ngarkesave mësimore dhe analizën dhe planifikimin e nevojave për PAE dhe PAK. Për këtë kërkesë të GVJ-së u dërgua një evidencë por që në brendësi të saj nuk përmban atë çfarë u pretendua se kanë dhe duhej të kishin.
- (2) GVJ konkludon se në IAL nuk kryhen diskutime dhe analiza për ngarkesën në këto programeve mësimore duke sjellë si pasojë mos respektim të cilësisë dhe standardeve të përcaktuara që mësimi të kryhet vetëm nga PAE që kanë grada shkencore për jo më pak se 70% të ngarkesës mesimore, si edhe për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie nevojitet zbatimi i Udhëzimit Nr.29, datë 12.09.2018 të MASR, pasi evidentohet se pothuajse të gjithë PAE-të kanë marrë orët suplementare prej 200 orë mësimore në auditor, përveçse orëve të tjera të punës për angazhime të tjera në IAL”.

### Komenti i GVB:



(1) GJV gjatë takimit me lektorët e Departamentit të Menaxhimit kërkoi informacion mbi mënyrën e miratimit të syllabuseve. Pasi lektorët treguan procedurën, GJV kërkoi evidencë, të cilat u mundësuan nga koordinatori i programit të studimit. Përkatësisht Evidenca nr.16 “Procesverbalin e mbajtur në departament për rastet e diskutimit të shpërndarjes së ngarkesës mësimore”.

GVB i vuri në dispozicion evidencën e kërkuar duke paraqitur 5 praktikave në vite të ndryshëm akademik. Konkretisht procesverbalet e datës 18.10.2016 (çështja mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor në kuadër të fillimit të vitit të ri akademik), 13.07.2017 (pika 3), 11.10.2017 (pika 10), 09.10.2018 (pika 2) dhe 14.10.2019 (çështja e dytë). Për sa i përket kërkesës mbi planifikimin e nevojave për PAE dhe PAK nuk kemi patur një kërkesë të tillë. Megjithatë, në të njëjtën evidencë të dërguar gjendet procesverbali i datës 11.10.2017 (pika 2).

(2) GVB thekson, se edhe paraqitja e evidencave në pikën 1, është në drejtim të respektimit të cilësisë dhe standarteve të kërkuara. Ky është një proces, edhe si tillë, vijon të përmirësohet në drejtim të standarteve të kërkuara. Ndaj vëmë në dukje se Departamenti i Menaxhimit është në respektim të plotë të Udhëzimit Nr.29, datë 12.09.2018 të MASR dhe veçanërisht të Pikës II “Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”. Me hyrjen në fuqi të udhëzimit nr.29 në vitin 2018 Departamenti Menaxhimit ka angazhuar në master lektor me grada dhe tituj Shkencor në përputhje të plotë me udhëzimin (Evidenca\_Nr.104\_Orari Master Profesional SME 2016-2019 + CV Stafit Akademik si edhe orari për vitin akademik 2019-2020).

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi evidencat e cituara nuk përmbajnë materialitet për ato çfarë kërkohet për tu konsideruar në plotësimin e kriterëve.

- **Fusha II Standarti II.2 Kriteri 6-7**

Konstatimi i GVJ:

GVJ citon në brendësi të shpjegimit të këtyre kriterëve, se: “GVJ konstaton se në kapakun e RVB-së si kordinator i këtij programi është shkruar emri i një prej pedagogëve të Departamentit të Menaxhimit i angazhuar edhe në këtë program studimi, ashtu siç edhe GVB përgjigjet për këtë kriter bazuar në Nenin 15 të Rregullores së Departamentit të Menaxhimit. Por, gjatë vizitës në IAL, në kohën e planifikuar për diskutim me kordinatorin e këtij program u paraqit Përgjegjësja e Departamentit të Menaxhimit duke u shprehur se detyrën e koordinorit të programit të këtij studimi e mbulon vetë Përgjegjësi i Departamentit duke depozituar një interpretim ligjor por jo një dokument zyrtar në sistemin e ASCAL me evidencën nr. 2, në rubrikën “Vizita në Institucion dhe dokumentacioni i marrë gjatë vizitës”. Ky dualizëm mes RVB-së dhe pretendimit gjatë takimeve në IAL, evidenton paqartësi në njohjen e detyrave mes përgjegjësit dhe stafit të departamentit (të cilët janë edhe pjesë e GVB-së).

Në përfundim GVJ risjell në vëmendje të IAL-së se detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë apo person përgjegjës duhet të jenë të përcaktuara dhe në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi, përndryshe zbatimi i tyre do të vijojë të ndeshë të tilla situata të mos njohjes së detyrave dhe përgjegjësive që ka secili dhe si rrjedhim mosmbarëvajtjen e këtij program studimi në UAMD.”

Komenti i GVB:

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





Referuar agjendës së vizitës të GVJ në ditën e dytë të takimit, takim me Koordinatorët e Programeve të Studimit, GVB sqaron se: GVB-ja është grup pune ad-hoc për procesin e akreditimit të programit dhe kordinatori i këtij grupi, GVB-së, është në funksion të realizimit të detyrave në kuadër të akreditimit (Evidenca Nr.25\_Memo per ngritjen e GVB). Ndërsa kordinatori i programit të studimit është një anëtar tjetër i departamentit, në këtë rast Përgjegjësi i Departamentit (Evidenca nr. 106 “Vendimi per Koordinatorët e programeve”).

Gjithashtu, sjellim në vëmendje edhe njëherë sqarimin mbi pikën 12 “Bazën ligjore ku përcaktohet se përgjegjësi i njësisë bazë duhet të jetë edhe kordinator i programeve të studimit”, të kërkuar si dokument shtesë pas vizitës të GVJ në IAL. Sqarimi vjen si mëposhtë:

Fakulteti i Biznesit në Mbledhjet e Dekanatit, shkresë me nr. 122 Prot, datë 07.02.2019, përcakton se Kordinatorët në Master Shkencor dhe Profesional janë Drejtuesit e njësisë bazë, ndërsa në programet Bachelor është një anëtar i Departamentit për secilin program të mbuluar nga departamenti. Arsytimi bazohet në:

(1) Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht në nenin 3 “Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë”: pika 1 “Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi”; Pika 2/b “Liria akademike garantohet nëpërmjet së drejtës: për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore”.

(2) Nisur nga pika 1, bazuar në këtë ligj, Drejtuesi i njësisë bazë “është përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore”, gjë e cila bën të mundur ndjekjen nga afër të procesit mësimor dhe veprimtarive të tjera në programet e masterit. Gjë kjo e cila ndikon pozitivisht në mbarëvajtjen e programit të studimit Master Profesional në “Drejtimin e SME-ve”.

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **ndryshon pjesërisht** pasi GVJ i referohet RVB-së si dokumenti kryesor për vlerësim si edhe rregullores së Departamentit të cituar në RVB. Ritheksojmë se ndarja e qartë e të drejtave dhe detyrimeve për çdo individ apo strukturë është prioritare për mirë funksionimin e këtij programi.

- **Fusha II Standardi II.5 Kriteri 2.**

Konstatimi i GVJ:

“Në përfundim, GVJ evidenton se Personeli Akademik Efektiv që është angazhuar në mësimdhënie në Programin MP “Drejtimi i SME-ve” në 39.3% të orëve mësimore nuk kanë një gradë më lartë sesa cikli i studimit ku japin mësim. Kjo është kryer në kundërshtim me Ligjin 80/2015 - Neni 59, pika 6. Megjithatë sipas evidences shtesë që u dha gjatë vizitës në IAL është shprehur që për vitin aktual akademik nuk do të ketë asnjë PAE pa grada shkencore në këtë program mësimor. Kjo ngelet për tu vlerësuar në të ardhmen.”

Komenti i GVB:

GVB citon se, ashtu sikurse citoj gjatë takimit, angazhime të tilla kanë ardhur si rrjedhojë e zhvillimit të institucionit dhe marrjes së gradës nga PAE. Njëkohësisht, edhe të pritjes së daljes së akteve të tjera nënligjore. Megjithatë, kjo është reflektuar duke u aktivizuar tashmë, në vitin aktual



akademik, dhe në vazhdimësi PAE/PAK të paktën me gradë shkencore. Raporti PAE/PAK në programin e studimit është reflektuar në vitin aktual akademik (orari për vitin akademik 2019-2020).

**GVJ:** Raporti për këtë pikë **nuk ndryshon**, pavarësisht se mund të jenë marr masat. Këto masa të marra tani do të verifikohen dhe do ti shërbejnë akreditimit të rradhës tjetër.

- **Fusha II Standardi II.5 Kriteri 4.**

Konstatimi i GVJ:

GVJ citon në brendësi të shpjegimit të këtij kriteri, se:

“Referuar diskutimit me studentët e këtij programi gjatë vizitës në IAL, evidentohet se ata kryesisht e gjejnë vet vendin ku të kryejnë praktikën profesionale. Procesi i sigurimit të praktikave profesionale të përshtatura me programin specifik mbart vështirësi për çdo IAL, pavarësisht punës së bërë prej tyre për krijimin e një bashkëpunim sa më të mirë me aktorët e tregut të punës”.

Komenti i GVB:

GVB, ashtu si ka cituar edhe gjatë takimit me GVJ, bazuar në rregullorën për zhvillimin e praktikave profesionale të programeve në ciklin e dytë pranë Fakultetit të Biznesit i ofrohen disa mundësi zgjedhje studentëve për të zhvilluar praktikën. Së pari, Marrëveshjet bashkëpunuese të Fakultetit të Biznesit dhe Departamentit të Menaxhimit ofrojnë dhe mbështesin mundësinë e studentëve për të zhvilluar praktikën profesionale. Kështu që, Fakulteti i Biznesit nxit, orienton dhe mbështet në mënyrë të vazhdueshme studentët në këtë drejtim. Së dyti, studenti me iniciativën e tij mund të gjej vetë biznesin/institucionin për të zhvilluar praktikën profesionale. Evidenca\_Nr.15\_(Rregullore e Praktikes Profesionale ne Fakultetin e Biznesit) Evidenca\_Nr.45\_(Marreveshjet e Bashkepunimit te Fakultetit te Biznesit) Evidenca\_Nr.45.1\_(Marreveshjet e Bashkepunimit te Departamentit te Menaxhimit)

**GVJ:** Raporti për këtë pikë **nuk ndryshon** pasi është një konstatim dhe nuk mohon përpjekjet e bëra nga IAL.

- **Fusha III. Standardi III.1 Kriteri 3**

Konstatimi i GVJ:

“GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve (Rregullorja e NJSBC, neni 6), si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakënaqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit (parashikuar në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, neni 83). Por sugjerohet që këto pyetësore të bëhen më shpesh dhe perfundimet tju bëhen të ditura dhe studentëve.”

Komenti i GVB:

GVB nuk bie dakord me konstatimin e GVJ pasi pyetësorët për vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve realizohen dy herë në vit, në dy semestra të vitit akademik, ku gjykohet se është mëse e mjaftueshme për të konstatuar objektivat e pyetësorit. Publikimi i rezultateve të pyetësorit tek studentët nuk gjykohet e arsyeshme nga ana jonë pasi kjo mund të influencojë qëndrimin nga ana e studentëve dhe mund të shkaktojë paragjyime tek ata për lektorët.

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **ndryshon**. GVJ konsideron të mjaftueshëm vlerësimin dy herë në vit nga studentët, por sugjerohet që perfundimet tju bëhen të ditura dhe studentëve, pa cituar emra të përvecëm.



- **Fusha III Standarti III.2 Kriteri 1.**

Konstatimi i GVJ:

“Format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të njohurive në UAMD përfshijnë: leksione dhe seminare të pandara, orë laboratorike, detyra/projekte kursi, praktikë profesionale, tema diplome (Statuti i ri UAMD, neni 72; Rregullore e re UAMD, neni 60; Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 51; Rregullorja e Masterit, neni 9). Nga një evidentim që GVJ i bëri planit mësimor të programit, MP në “Drejtimi i SME-ve” ka 60 kredite në total nga të cilat 26 fitohen në semestrin e parë, 18 në semestrin e dytë, 6 praktika profesionale dhe 10 mikroteza (Evidenca: “Riorganizim i Programit MP në Drejtimi i SME-ve”; “Plani mësimor MP në Drejtimi i SME-ve”).

Sugjerojmë që këto specifika të integrohen edhe në rregulloren e programit të studimit, duke e bërë atë më të personalizuar dhe detajuar.”

Komenti i GVB:

*GVB nuk bie dakord me konstatimin e GVJ për mos integrimin nga ana jonë e këtyre specifikave edhe në rregulloren e programit të studimit pasi ato rezultojnë të cituara në këtë rregullore, rregullore kjo e vënë në dispozicion të GVJ në formë elektronike në periudhën e aplikimit për akreditimit të programit të studimit në fjalë (Evidenca\_Nr.9\_Rregullore e Master Profesional Drejtimi i SME-ve). Përkatësisht këto specifika gjenden të cituara në nenin të kësaj rregullore.*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. Rregullorja e programit përfshin rregulla të përgjithshme që rrjedhin nga ligji i arsimit të lartë dhe vendimet përkatëse, por pa i personalizuar ato për programin e studimit në fjalë.

- **Fusha III. Standardi III.2 Kriteri 4.**

Konstatimi i GVJ:

“Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kryesisht kriteret ligjore të kualifikimit, pasi ka lektorë të cilët janë ende në proces doktorature. Për lëndët dhe modulet ekzistojnë tekste, leksione dhe materiale të tjera që u vihen në dispozicion studentëve, të mundësuar edhe nga libraria e universitetit. Gjatë vizitave në institucion, u evidentua që aty ishin vetëm një numër i kufizuar i literatures bazë dhe mbështetese dhe botime deri në vitin 2015.”

Komenti i GVB:

*Duke konsideruar si detyrë parësore plotësimin e objektivave të MP “Drejtimi i SME-ve”, Departamenti i Menaxhimit është treguar mjaft i kujdesshëm në zgjedhjen e stafit të angazhuar. Kështu, lektorët e përfshirë në këtë program studimi kanë njohuritë e duhura që u duhen transmetuar studentëve dhe aftësitë e nevojshme për ta mundësuar këtë. Kjo dëshmohet edhe përmes background-it profesional, përvojës arsimore dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore të stafit të angazhuar në këtë program studimi (Evidenca\_Nr.52\_(Te dhenat për aktivitetet për kualifikimin dhe kerkimit shkencor për anetaret e departamentit në 5 vitet ~1). GVB nuk bie dakord me konstatimin e GVJ për një numër të kufizuar të literaturës bazë dhe mbështetëse gjë e cila u evidentua edhe gjatë takimit të stafit me GVJ. Vetë stafi akademik i Departamentit të Menaxhimit angazhohet në përditësimin e teksteve, leksioneve apo materialeve të tjera që u mundësohen studentëve, Hartimi i këtyre materialeve mundësohet edhe nga mbështetja e ofruar nga Biblioteka e Fakultetit të Biznesit dhe Univeristetit “Aleksandër Moisiu”, e cila përveç burimeve fizike mundëson edhe akses në burime elektronike. Kështu, stafi akademik është i angazhuar në rifreskimin e materialeve të ofruara duke shtuar koncepte apo çështje të reja dhe duke përgatitur studime rasti që i ilustronjë sa më mirë ato (Evidenca\_Nr.82 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme).*





**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. Vizita fizike në Biblioteke dëshmoi konstatimet e vëna më sipër në dukje nga GVJ. GVJ nuk ka për objekt vlerësimin e njohurive “soft” të lektorëve, por bazohet në faktet e vëna në dispozicion.

- **Fusha III. Standardi III.3 Kriteri 2.**

Konstatimi i GVJ:

“Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve mbeten ende për tu pajisur me kompjutera e projektorë.

Kampusi universitar i UAMD ku ndodhet Fakulteti i Biznesit, duke qenë një ndërtim i ri me standarde bashkëkohore teknike, ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m<sup>2</sup> / student.”

Komenti i GVB:

*GVB bie dakord me konstatimin e GVJ se sallat e leksioneve mbeten ende për tu pajisur me kompjutera e projektorë por kjo nuk mund të konsiderohet si mangësi pasi IAL ka proceduar në një mënyrë tjetër për krijimin e kushteve bashkëkohore teknike duke pajisur me kompjutera dhe projektorë lektorët dhe jo sallat e leksioneve. Kjo për të ruajtur materialet nga dëmtimi.*

*Në këto kushte vetë Departamenti i Menaxhimit disponon në zyrën përkatëse projektorë dhe laptope. Gjithashtu, pjesa më e madhe e lektorëve të Departamentit të Menaxhimit disponon laptope dhe projektorë personalë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit.*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. Vizita fizike në institucion dëshmoi konstatimet e vëna më sipër në dukje nga GVJ.

- **Fusha III. Standardi III.3 Kriteri 3.**

Konstatimi i GVJ:

“UAMD ka pajisur zyrat e personelit akademik me zyra të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. Por nga vizita në godinë dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, GVJ- së iu referua se pika të dobëta në departament mbeten logjistika IT e programet kompjuterike. Gjithashtu, siç e përmendëm edhe më sipër, mbeten ende sallat e leksioneve për tu pajisur me kompjutera e projektorë.”

Komenti i GVB:

*Sikurse u përmend edhe më sipër GVB bie dakord me konstatimin e GVJ se sallat e leksioneve mbeten ende për tu pajisur me kompjutera e projektorë por kjo nuk mund të konsiderohet si mangësi pasi vetë Departamenti i Menaxhimit disponon në zyrën përkatëse projektorë dhe laptope. Ashtu si ju bë me dije GVJ edhe gjatë takimit me lektorët mungesa e këtyre paisjeve nuk ka krijuar pengesa në procesin e shpërndarjes së dijës pasi një pjesë e lektorëve kur e kanë patur të nevojshme kanë përdorur dhe paisjet personale. Paisja e lektorëve me programe të posaçme për lëndë të veçanta mbetet një sfidë për IAL dhe departamentin e menaxhimit.*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. Vizita fizike në institucion dëshmoi konstatimet e vëna më sipër në dukje nga GVJ, ku sallat e leksioneve mbeten ende për tu pajisur me teknologjiine e nevojshme.



- **Fusha III Standarti III.3 Kriteri 4.**

Konstatimi i GVJ:

“Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Materialet fizike ofrohen në librarinë e Fakultetit të Biznesit. Biblioteka ofron tituj bazë dhe materiale mbështetëse në shqip si edhe në gjuhë të huaj, por nga vizita në Bibliotekë rezultoi se numri ishte i kufizuar dhe botime të vjetra. Megjithatë, studentët dhe pedagogët mund të aksesojnë artikujt të ndryshëm si material mbështetëse nëpërmjet abonimit që universiteti ka bërë në EBSCO.”

Komenti i GVB:

*Stafi akademik i Departamentit të Menaxhimit është vazhdimisht i angazhuar në rifreskimin e materialeve që u ofrohen studentëve, duke shtuar koncepte apo çështje të reja dhe duke përgatitur studime rasti që i ilustrjnë sa më mirë ato. Kjo vjen si rrjedhojë e faktit që stafi akademik është mjaft aktivë në aktivitetet kërkimore-shkencore (publikime në revista, pjesëmarrje në konferenca etj.) dhe është kështu në kontakt të vazhdueshëm me të rejat në fushën e menaxhimit (Evidenca\_Nr.32\_CV e Stafit Akademik në MP Drejtimi i SME-ve; Evidenca\_Nr.43\_(Fushat e Studimit për anetaret e Departamentit të Menaxhimit). Sa më sipër, mundësohet edhe nga bashkëpunimi i ngushtë i stafit akademik me Bibliotekën e Fakultetit të Biznesit, e cila mundëson akses në burime fizike dhe elektronike.*

*Referuar vjetërsisë së burimeve të ofruara nga Biblioteka, mund të themi se nuk mund të nënvlerësojmë rëndësinë dhe rolin e autorëve më të hershëm (një pjesë e mirë e tyre mund të quhen “kolosët e menaxhimit”) në formimin dhe zhvillimin e menaxhimit. Konceptet dhe teoritë e ndryshme të evidentuara në literaturë studiohen dhe analizohen në formën e “critical thinking”. Diskutimet pasurohen me eksperiencat e gjithësecilit në auditor, të cilat të kombinuara edhe me kushtet korrente dhe studime rasti të kompanive reale synojnë të nxjerrin përfundime që i përshtaten sa më shumë kontekstit aktual (Evidenca\_Nr.82\_Biblioteka Online të dhëna mbi materialet e disponueshme).*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. Vizita fizike në Bibliotekë dëshmoi konstatimet e vëna më sipër në dukje nga GVJ.

- **Fusha III Standarti III.3 Kriteri 5.**

Konstatimi i GVJ:

“Biblioteka vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit.

GVJ sygjeron që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duhet të pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhurnimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga vizita në Institucion rezultoi që biblioteka nuk përdoret shumë nga studentët.”

Komenti i GVB:

*GVB vlerëson sugjerimin e GVJ mbi pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me literaturë shqipe dhe të huaj edhe pse sikurëse përmendet më sipër, stafi akademik i Departamentit të Menaxhimit është vazhdimisht i angazhuar në rifreskimin e materialeve që u ofrohen studentëve, duke shtuar koncepte apo çështje të reja dhe duke përgatitur studime rasti që i ilustrjnë sa më mirë ato.*

*Vetë Departamenti i Menaxhimit, Fakulteti i Biznesit, Biblioteka e institucionit si edhe UAMD inkurajojnë vazhdimisht pjesëmarrjen e studentëve në bibliotekë nëpërmjet realizimeve të takimeve informuese por edhe nëpërmjet rrjeteve sociale dhe faqes web të UAMD-së*

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



(Evidenca\_Nr.82\_Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme). Fakti që një pjesë e studentëve nuk aksesojnë në bibliotekë, kjo mbetet në dëshirën e tyre dhe kohën që mund të kenë në dispozicion.

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. Gjatë vizites fizike në Biblioteke GVJ konstatoi botime te vitit 2015 si botimet më të fundit dhe këto në pak fusha lidhur me programin e studimit.

- **Fusha III Standarti III.3 Kriteri 6.**

Konstatimi i GVJ:

“Në RVB theksohej për aksesin në librarinë online, por kjo rezultoi se nuk përdorej nga studentët me të cilët GVJ zhvilloi takimin. Universiteti përfshihet në Bibliotekën Dixhitale të mundësuar nga RASH.”

Komenti i GVB:

*Bazuar në Statutit e IAL, Rregulloren e Fakultetit të biznesit, Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit, si dhe rregullores së Bibliotekës së UAMD Departamenti dhe të gjithë të lart përmendurit janë përgjegjës vetëm për informimin e studentëve mbi aksesin në librarinë online. Fakti që një pjesë e studentëve nuk aksesojnë në bibliotekën online, kjo mbetet në dëshirën e tyre, kohën që mund të kenë në dispozicion si dhe mundësinë për të aksesuar ose jo.*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. GVJ ka cituar gjetjet nga intervista me studentet.

- **Fusha III. Standardi III.7 Kriteri 1.**

Konstatimi i GVJ:

“Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studenti thëllon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit. GVJ konstatoi se Kurrikula e rishikuar përmban më pak lëndë dhe nuk parashikon lëndë të formimit bazë për studentët me formim jo ekonomik. Sugjerohet të përfshihen lëndë të manaxhimit, marketingut dhe financës me fokus SME-të, si psh. “Sipërmarrja dhe Drejtim i SME-ve”, “Marketingu i SME-ve”, etj, në mënyrë që kurrikula të ofrojë thellim dhe profilizim të studentëve në SME. Në të kundërt, duke marrë parasysh edhe numrin e vogël të studentëve në hyrje dhe dalje të studimeve të këtij program, sugjerohet shkrirja e këtij masteri dhe bashkimi me masterin MP në “Menaxhim Biznes”.”

Komenti i GVB:

*Kurrikula e MP “Drejtimi i SME-ve” është formuluar duke iu referuar objektivave specifike të këtij programi studimi. Duke pasur si synim bazë paisjen e studentëve me njohuritë dhe aftësitë teorike dhe praktike më të rëndësishme për menaxhimin e SME-ve i është dhënë më shumë prioritet lëndëve karakterizuese dhe atyre ndërdisiplinore/integruese. Kështu, përveç lëndëve të tilla si “Menaxhimi i Biznesit të vogël dhe të mesëm”, “Menaxhimi i avancuar” apo “Menaxhimi logjistik” të cilat ofrojnë njohuri të domosdoshme lidhur me drejtimin e SME-ve, gjejmë në kurrikulën e këtij programi studimi edhe lëndë si “Drejtimi financiar” apo “Marketingu i avancuar” në mënyrë që studentët të kenë edhe njohuri në fushën e financës apo marketingut. Këtyre u shtohen edhe “Drejtimi i avancuar i projektit” si një lëndë mjaft e rëndësishme në kushtet e një mjedisi dinamik dhe që mundëson aftësimin në krijimin e avantazheve konkurruese dhe “Menaxhim shërbimesh” meqënëse një pjesë e mirë e SME-ve operojnë në sektorin terciar. Vlen për t’u theksuar se, pavarësisht se ndonjë prej lëndëve të përfshira në kurrikul mund të ketë një emërtim të përgjithshëm, trajtimi i saj fokusohet tek SME-të.*

*MP “Drejtimi i SME”-ve dhe MP “Menaxhim Biznesi” janë dy programe studime që dallojnë dhe secili ka specifikat e tij. Kjo është e dukshme në objektivat që secili prej tyre synon të arrijë dhe*

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

*gjithashtu edhe në kurrikulat e tyre (Evidenca\_Nr.24.1\_Plani Mesimore ne MP Drejtim i SME V.A. 2016-2018, Evidenca\_Nr.24\_(Plani Mesimore ne Master Profesiona ne Drejtimi i SME, V.A. 2018-2019, Evidenca\_Nr.24\_(Plani Mesimore ne Master Profesional ne Menaxhim Biznesi, V.A. 2018-201, Evidenca\_Nr.24.1\_(Plani Mesimore ne MP Menaxhim Biznesi V.A. 2013-2018).*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. Programi i studimit është rishikuar dhe në këtë rishikim “emërtim i përgjithshëm” i disa lëndëve mund të specifikohet sipas nevojës së programit të studimit. Gjithashtu, sugjerimi për shkrimin e këtij masteri dhe bashkimi me masterin MP në “Menaxhim Biznes”, vjen jo vetëm nga vlerësimi kompleks i programit por edhe nga rekomandimi i bërë më parë nga vet NJSBC në UAMD.

- **Fusha III Standarti III.7 Kriteri 10.**

Konstatimi i GVJ:

Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurrur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.

Nga takimi në institucion na u komunikua që nuk ka pasur interes nga studentët master, për mobilitetin në kuadër të marrëveshjeve që ka UAMD, pasi ata janë edhe në marrëdhënie pune.”

Komenti i GVB:

*Departamenti i Menaxhimit, Fakulteti i Biznesit, si edhe UAMD janë përgjegjës vetëm për informimin e studentëve mbi pjesëmarrjen në mobilitete të ndryshme ku vetë UAMD apo fakulteti i Biznesit ka marrëveshje. Fakti që një pjesë e studentëve nuk tregojnë interes, kjo mbetet në dëshirën e tyre dhe kohën që mund të kenë në dispozicion.*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**, bazuar në gjetjet gjatë bashkë bisedimeve me studentët.

- **Fusha III Standarti III.8 Kriteri 1-2.**

Konstatimi i GVJ:

“UAMD ka realizuar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike kryesisht dhe private, (Evidenca 45. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit; 45.1. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit; 45.2. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; 45.3. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s), të cilat shfrytëzohen edhe për praktikën profesionale të studentëve të programeve master.

GVJ konstatoi gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët se studentët e masterit profesional në “Drejtim i SME-ve” kryejnë praktikën në institucione kryesisht publike apo financiare (p.sh NOA) dhe shumë pak prej tyre shkojnë pranë bizneseve.

Sugjerohet të shtohet lista e bashkëpunimeve me biznese sidomos SME dhe studentët të orientohen më tepër drejt praktikave në SME, në mënyrë që të përfitojnë aftësitë profesionale (të synuara edhe nga vetë programi i studimit).”

Komenti i GVB:

*Vetë ky program studimi është projektuar pikërisht për t’iu ardhur në ndihmë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke rritur shkallën e specializimit, profesionalitetit dhe aftësitë e drejtuesve dhe punonjësve të tyre. Për këtë arsye, Departamenti i Menaxhimit është përgjegjës mbi informimin dhe orientimin e studentëve për kryerjen e praktikave studimore kryesisht pranë këtyre bizneseve. Informacioni i cili prezantohet tek studentët 2 herë gjatë vitit akademik. Në të njëjtën kohë studenti gëzon të drejtën e plotë të informimit mbi këto praktika pranë Departamentit të Menaxhimit ashtu*



sikurëse është e drejta e tij e plotë mbi përzgjedhjen e institucionit apo biznesit për kryerjen e praktikës mësimore.

Vetë Departamenti i Menaxhimit, Fakulteti i Biznesit dhe UAMD gëzon një listë të pasur të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe biznese. Veçanërisht, pjesa dërrmuese e bashkëpunimeve të Departamentit të Menaxhimit kryesohet nga biznese (Evidenca Nr.45 “Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit”, Evidenca Nr.45.1 “Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit”, Evidenca Nr.45.3 “Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s”, evidenca këto të vëna më parë në dispozicion të GVJ në formë elektronike. Në këto kushte mund të themi se orientimi i studentëve për realizimin e praktikave mësimore nga ana e departamentit, realizohet më së miri, referuar evidencave në fjalë.

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. Sugjerimi vjen nga pasqyrimi i eksperiencave të studentëve të vëna në dukje gjatë vizitës në institucion.

- **Fusha IV Standarti IV.1 Kriteri 1**

Konstatimi GVJ:

“GVJ në brendësi të shpjegimit të këtij kriteri citon se nga verifikimi i dosjeve të PAE-ve dhe evidencave për ngarkesën mësimore në këtë program mësimor dhe gradën përkatëse të çdo PAE rezultuan mospërputhje në grada dhe se në këtë program ishin angazhuar në mësimdhënie PAE pa gradë shkencore.

Komenti GVB:

GVB citon se, ashtu sikurse citoj gjatë takimit, angazhime të tilla kanë ardhur si rrjedhojë e zhvillimit të institucionit dhe marrjes e gradës nga PAE. Njëkohësisht, edhe të pritjes së daljes së akteve të tjera nënligjore. Megjithatë, kjo është reflektuar duke u aktivizuar tashmë, në vitin aktual akademik dhe në vazhdimësi PAE/PAK, të paktën me gradë shkencore.

**GVJ:** Raporti për këtë pikë **nuk ndryshon**, pavarësisht se mund të jenë marr masat. Këto masa të marra tani do të verifikohen dhe do të shërbejnë akreditimit të rradhës tjetër.

- **Fusha IV Standarti IV.1 Kriteri 2.**

Konstatimi i GVJ:

"GVJ citon në brendësi të shpjegimit të këtyre kriterëve, se:

- (1) GVJ gjatë diskutimit me drejtuesit e IAL-së u bë me dije se është njësi bazë ajo e cila në fillim të vitit akademik përcakton dhe paraqet pranë Dekanatit nevojat për staf shtesë PAE ose PAK dhe kriteret që duhet të plotësojë. Dekanati i përcjell pranë Rektoratit i cili e përcjell kërkesën tek Drejtoria e Burimeve Njerëzore (DBNJ) e cila harton oferta e punës duke përfshirë këtu kriteret e pranimit, të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara nga njësi bazë. Këto kërkesa shpalljen në njoftimin për vend pune vakant në web si dhe në buletin e APP-së. Pas marrjes së aplikimeve krijohet komisioni at- hoc i ngritur nga Dekanati me përfaqësues të njësisë bazë dhe me një përfaqësues nga Rektorati për vlerësimin e dosjeve dhe zhvillimin e intervistave për kandidatët.
- (2) GVJ kërkoi të depozitoheshin në ASCAL praktikat e rekrutimeve të PAE të kryera gjatë 3 viteve të fundit me qëllim evidentimin e procedurave dhe hapave të ndjekur. Nga IAL u depozitua vetëm një praktikë e cila nuk përkon me PAE të angazhuar në këtë program dhe si rrjedhim nuk mund të merret për referencë, ndërkohë që munguan të depozitohen praktika të tjera. GVJ konstaton mungesë transparence në RVB për mos kthim përgjigje sipas kriterëve të kërkuara në manualin e vlerësimit, si edhe stafi që angazhohet në mësimdhënie në ciklin e





dytë duhet të ketë status të qartë në të gjitha evidencat dhe të mos shfaqet ndryshe në evidenca të ndryshme që do të thotë se në këtë program duhet të angazhohen vetëm staf akademik me grada shkencore."

Komenti i GVB:

(1) Në këtë kriter, GVJ kërkon gjithashtu të bëjë një saktësim sa i përket vlerësimit për procedurën e rekrutimit të stafit akademik. Në bazë nenit 64 të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", është njësia bazë, pra Departamenti i Menaxhimit, që inicion procedurat e rekrutimit të stafit akademik dhe merr vendimin përfundimtar në bazë edhe të rregulloreve dhe statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Komisioni at-hoc ngrihet nga njësia bazë me anëtar të njësisë dhe përfaqësues nga dekanati e rektorati.

(2) GVB nuk bie dakord me konstatimin e GVJ për mungese transparence dhe mosdërgim material pasimi në kemi shprehur qartë që në periudhën 2017-2020 në departamentin ofruar të programit nuk është realizuar rekrutim stafi me kohe të plotë. Mosrekrutimi në këtë periudhë është një e dhënë e qartë dhe e vënë në dispozicion në formën e tabelave të stafit për çdo vit akademik dhe i është bërë e ditur GVJ edhe në takimin me Burimet Njerëzore. Me qëllim transparencën maksimale i është vënë në dispozicion GVJ procedura e rekrutimit më e vonë në departament. Dosja e rekrutimit që iu është dërguar përbën rekrutimin më të fundit të stafit akademik me kohë të plotë të kryer nga Departamenti i Menaxhimit dhe dërgimi i kësaj dosje kishte për qëllim vetëm ilustrimin e procesit të rekrutimit.

**GVJ:** Raporti për këtë pikë **nuk ndryshon**, pasi RVJ i referohet rekrutimeve të kryera për këtë Program mësimor në 3 vitet e fundit dhe jo rekrutimeve të bëra nga Departamenti Menaxhimit.

- **Fusha IV Standarti IV.1 Kriteri 3.**

Konstatimi i GVJ:

"Referuar evidencave të dërguara nga IAL, përsëri GVJ evidenton se nuk rezultojnë që DM të ketë kryer mbledhje ku të ketë diskutuar, analizuar dhe përcaktuar kërkesat dhe kriteret ashtu siç kërkohen nga kriteret dhe standardet përkatëse".

Komenti i GVB:

GVB nuk bie dakord me konstatimin GVJ, pasi në evidencat vëna në dispozicion janë edhe procesverbalet e mbledhjeve të vëna në dispozicion, përkatësisht në procesverbalet e mbledhjes së datës 13.7.2017 ku janë verifikuar ngarkesat faktike të personelit akademik. Në mbledhje e datës 11.10.2017 është diskutuar rekrutimi i PAK. Në procesverbalin e mbledhjes së datës 9.10.2018 është diskutuar ndarja e ngarkesës mësimore e evidentuar gjithashtu dhe në procesverbalin e mbledhjes së datës 19.10.2019.

**GVJ:** Raporti për këtë pikë **nuk ndryshon**, pasi RVJ i referohet mbledhjeve të Njesisë Bazë ku të ketë diskutuar, analizuar dhe përcaktuar kërkesat dhe kriteret ashtu siç kërkohen nga kriteret dhe standardet përkatëse. Evidencat e depozituara nga IAL nuk përmbajnë ato çfarë kërkohen.

- **Fusha IV Standarti IV.1 Kriteri 4.**

Konstatimi i GVJ:

“GVJ i sygjeron IAL-së të ketë në Rregulloren e Rekrutimit të pasqyruara kriteret e përgjithshme për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor. Këto kriteret të përfshijnë notën mesatare të ciklit të parë dhe notën mesatare të ciklit të dytë të studimeve, profilin e studimit, shkollim dhe kualifikim të mëtijshëm, përvojën e punës në mësimdhënie, kualifikime brenda apo jashtë vendit, njohuri të gjuhëve të huaja, aktiviteti botues shkencor, etj”.

Komenti i GVB:

*Kriteret e përgjithshme për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor e propozuara nga GVJ mund të vendosen si element bazik për përzgjedhjen e stafit në Rregulloren e Rekrutimit. Nuk mund të jenë domosdomërisht kriteret pasi është vetëm një rregullore për 6 fakultete në Universitetin “Aleksandër Moisiu”. Si e tillë, secili fakultet dhe departament ka specifikat e tij dhe nevoja të ndryshme nga njëri-tjetri. Por, normalisht, të jenë konform kriterëve ligjore.*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon** pasi GVJ i ka përcjellë IAL-së një sygjërim bazuar në praktikën më të mirë vetëm për vendosjen e kriterëve të përgjithshme në Rregulloren e Rekrutimit dhe jo vendosjen e të gjitha kriterëve që mund të jenë të veçanta sipas njësive bazë apo njësive kryesore të UAMD-së.

- **Fusha IV Standarti IV.5 Kriteri 2.**

Konstatimi i GVJ:

“Veprimtaria e personelit akademik të këtij programi studimi, nuk gjendet e pasqyruar në website të UAMD-së me qëllim që të interesuarit për nivelin akademik të pedagogëve të mundë të marrin informacion në distancë për ata si edhe për të mbajtur komunikim në marrëdhënien pedagog-student”.

Komenti i GVB:

*Në faqen e internetit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës gjenden të publikuara curriculum vitae të stafit akademik, ku pasqyrohet edhe veprimtaria e tyre akademike dhe kërkimore-shkencore. Ndërkohë, vetë veprimtaria gjendet e publikuar në vendet ku ajo është kryer (revista shkencore, konferenca shkencore, programe shkëmbimi me universitetet e tjera, etj.).*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **ndryshon pjesërisht** duke shtuar mundësinë e gjetjes së informacionit në CV-të e stafit akademik në website të UAMD-së.

- **Fusha IV Standarti IV.5 Kriteri 3-6.**

Konstatimi i GVJ:

“GVJ citon në brendësi të kriterit se:

- (1) Përmes diskutimit gjatë vizitës në IAL, prej të intervistuarve u evidentua se institucioni nuk disponon sistem të menaxhimit të informacionit nëpërmjet të cilit të mund të administrohen të gjithë informacionet që lidhen me stafin dhe studentët, aktivitetin e tyre dhe platformë interaktive komunikimi për programin e studimit MP “Drejtimi i SME-ve”.
- (2) Në lidhje me funksionimin e faqes së internetit gjatë takimit me njësinë respektive të marrëdhënies me publikun u testua website i UAMD për një njoftim për vende pune në UAMD dhe u evidentua që në versionin celular ky link nuk hapej.
- (3) GVJ evidenton se UAMD duhet të implementoj sistemin e menaxhimit të informacionit edhe për stafin dhe studentët e programit të studimit MP “Drejtimi i SME-ve” pasi ai siguron akses në informacione dhe dokumenta si për stafin e UAMD-së edhe për studentët e



këtij programi studimi. Përmes implementimit të SMB për të gjithë, do të sigurohet edhe adresimi i disa prej kërkesave dhe kritereve të kërkuara për UAMD-në.”

#### Komenti i GVB:

- (1) Në asnjë moment, as Standardi IV.5 dhe as kriteret shtjelluese nuk përcaktojnë se sistemi i menaxhimit të brendshëm duhet të jetë domosdoshmërisht i llojit informatik, ndonëse Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës i disponon të dy llojet (sistemin tradicional të menaxhimit të brendshëm dhe sistemin informatik të menaxhimit të brendshëm). Me anë të dokumenteve mbështetëse, GVB ka dëshmuar se sistemi tradicional i menaxhimit të brendshëm është i shtrirë në formë kapilare në të gjithë strukturën dhe infrastrukturën e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, duke përfshirë këtu edhe Fakultetin e Biznesit. Njëkohësisht, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës disponon edhe sistemin informatik të menaxhimit të brendshëm, i cili ndërlidh dhe koordinon rrafshin administrativ, rrafshin akademik dhe rrafshin studentor. Ky sistem aktualisht shtrihet në rrafshin administrativ, në rrafshin akademik dhe deri tek studentët e ciklit të parë të studimeve, ndërkohë që vijon puna për përfshirjen edhe të studentëve të ciklit të dytë.
- (2) GVB fton GVJ që vlerësimin e vet mbi funksionalitetin e faqes së internetit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, duke u bazuar tek një provë në telefonin celular për të dalë në përfundimin se “u evidentua që në versionin celular ky link nuk hapej”, pasi ka qenë ndonjë problematikë teknike në ato momente. Aktualisht web-i universitetit edhe nëpërmjet versionit celular është në funksion të plotë.
- (3) Çdo vonesë në këtë drejtim ka ardhur pak edhe nga platformat e reja informatike që Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka prezantuar, me qëllimin për të përqendruar dhe njësuar sistemet informatike të menaxhimit të IAL publike. Në këtë pikë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës mbetet një nga të mirët në fushën e përdorimit të teknologjisë së informacionit, pasi ka qenë IAL i parë që ka nisur të përdorë sistemet informatike të menaxhimit të brendshëm, veçanërisht në marrëdhënie me studentët.

**GVJ:** Raporti në këto kritere **nuk ndryshon**. Komentet e sjella nga GVB nuk i përkasin specifikisht gjetjeve të konstatuara për këtë program studimi pasi GVJ nuk i është referuar ciklit të parë të studimit. Pika e dytë ka një axhustim në fjali por pa ndryshuar kuptimin pasi është një konstatim on-site në prezenc të përfaqësuesve të IAL-së, pavarësisht se GVJ nuk e shikon këtë si gjetje matëriale dhe nuk e ka të evidentuar në rekomandimet finale. Megjithatë, përgëzojmë angazhimin e IAL-së në adresimin e mirë funksionimit të ëbsitit të tij edhe në versionin celular duke ditur që kryesisht studentët janë përdorues të këtij mjeti komunikimi më tepër sesa desktop.

- **Fusha VI Standarti VI.1 Kriteri 1-4.**

#### Konstatimi i GVJ:

“GVJ në brendësi të shpjegimit të këtyre kritereve citon se:

- (1) NJSBC e ka të vështirë të monitorojë të gjitha programet e ofruara nga UAMD. Për këtë arsye dhe si pasojë e nevojave imediate të institucionit për akreditimin e disa programeve studimore njëkohësisht, është ngritur NJSBC pranë Fakulteteve përkatëse ku anëtarë janë shefat e çdo departamenti dhe 2 zv/dekanet. Kjo strukturë e dytë mund të shërbejë si ndihmë njësisë kryesore por, mendojmë që krijon konflikt interesi në vetvete si edhe mbi-vendosje detyrash për përgjegjësat e departamenteve. Në përfundim, GVJ mendon se NJSBC pranë UAMD nuk funksionon plotësisht.
- (2) Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë pranë secilit Fakultet. Në këtë Njësi përfshihen personel i brendshëm i Universitetit; por nuk

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, çka e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, siç e pasqyron organigrama. Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.

- (3) UAMD nuk pasqyron në raportin vjetor të cilësisë masat e ndërmara në lidhje me raportet e ekspertëve të jashtëm dhe rekomandimet e tyre. Ajo që nevojitet të shënohet është fakti i angazhimit i po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra. Në raportin vjetor të NJSBC nuk ka një analizë në lidhje me instrumentat e sigurimit të cilësisë të përdorura gjatë vitit akademik, si psh rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e pedagogëve, konkluzionet e nxjerra dhe plan aksioni për t'i vendosur në funksion. Sugjerohet pavarësia e stafit në hallkat e sigurimit të cilësisë, rishikimi i instrumentave për të garantuar përdorshmërinë e tyre dhe përfshirja e përdorimit të instrumentave në analizën vjetore të NJSBC.
- (4) Përveç përdorimit të mekanizmave të mësipërme, siguri i cilësisë shtrihet edhe në rekrutimin e stafit, organizimin e programit mësimor, zhvillimin e programit dhe kërkimin. NJSBC në çdo rast është prezent për të siguruar cilësinë dhe për të krijuar një kulturë në rang institucional. Ajo që nevojitet të shënohet është fakti në angazhimin e po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra. Sugjerohet pavarësia e stafit në hallkat e sigurimit të cilësisë”.

#### Komenti i GVB:

*Në fushën e sigurimit të cilësisë së programeve të studimit në veçanti dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë në përgjithësi, përpjekja e vazhdueshme e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës është që të ndërtohen struktura të forta dhe transparente, të vendosura këto mbi dokumente (kode, rregullore, manuale, etj.) të qarta, në mënyrë që të shmanget në maksimum subjektivizmi. GVB mendon se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka hartuar gjithë dokumentet e nevojshme dhe ka ngritur strukturën e vet të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Stafit akademik i Fakultetit të Biznesit është padyshim pjesë e gjithë sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kjo nuk është aspak mangësi apo subjektivitet apo konflikt interesi. Kjo është pjesë e përpjekjeve dhe punës së përditshme të të gjithëve në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës në funksion të sigurimit e të përmirësimit të cilësisë dhe stafi akademik as nuk është i përjashtuar dhe as nuk mund të përjashtohet nga kjo ndërmarrje.*

*Në shpjegimet e dhëna për këto kritere dhe në dokumentet e bashkangjitura në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, GVB e ka bërë të qartë se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës disponon strukturën e vet të posaçme të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe ka adoptuar dokumentet e duhura për të garantuar funksionimin e saj efektiv. Ngritja edhe pranë fakulteteve e njësisve të sigurimit të brendshëm të cilësisë nuk përbën aspak ngritjen e strukturave paralele apo mbivendosje detyrash për stafin akademik. Struktura të tilla pranë fakulteteve, siç është edhe ajo pranë Fakultetit të Biznesit, është dëshmi e punës për matjen e cilësisë, identifikimin e mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm.*

*Pjesëmarrja në këto struktura e drejtuesve të njësisve bazë nuk përbën dyzim apo mbivendosje detyrash ose subjektivizëm të personave përkatës, por është shprehje e angazhimit të autoriteteve të zgjedhura të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës për të përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat që kanë.*

*Qëllimi madhor i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës sa i përket sigurimit të brendshëm të cilësisë është ndërtimi i strukturave dhe procedurave të qarta, me qëllim shmangien në maksimum të subjektivizmit. Kjo është realizuar, gjë që e ka nënvizuar edhe GVJ në vlerësimin e dhënë për*



*Kriterin 4. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë funksionon kudo, në çdo qelizë të Universitetit "Aleksandër Moisiu", pasi analizat e performancës dhe cilësisë zhvillohen periodikisht dhe rregullisht në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe në nivel universiteti.*

*Gjithashtu, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës është objekt edhe i strukturave të vlerësimit të jashtëm të sigurisë, përfshirë këtu edhe nga ASCAL. Në bazë të Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 10, datë 07.04.2017, "Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës", standardet e cilësisë së arsimit të lartë ishin përmbushur plotësisht në katër fusha vlerësimi dhe përmbushur kryesisht në një fushë vlerësimi, ndërkohë që rekomandimet e lëna për sigurimin e cilësisë janë tashmë përmbushur.*

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. GVJ mendon bazuar në evidencat e vëna në dispozicion si edhe takimet e zhvilluara në institucion se NJSBC nuk ushtron të plote funksionin e saj. GVJ vlerëson zgjidhjen ad-hoc të IAL-së për situatën e akreditimit të disa programeve njëkohesisht, por sugjerojmë fort ngritjen e një zyre NJSBC të shendoshë pranë UAMD. Për më tepër, mënyra e kryerjes së vlerësimeve është plotësisht në konflikt interesi, ku shefi i departamentit dhe dekani kontrollon programet e njësisë së tij. Nevojitet (në zbatim të Rregullores së UAMD dhe ligjit për arsimin e lartë) një organ i pavarur (zyra e NJSBC) për të ushtruar këtë funksion, jo vetëm për programet e studimit por edhe zyrat mbështetëse si Burimet Njerezore, Biblioteka, Alumni, etj.

- **Fusha VI Standarti VI.2 Kriteri 1-5.**

#### Konstatimi i GVJ:

"GVJ në brendësi të shpjegimit të këtyre kritereve citon se:

- (1) Siç përmendet edhe tek Raporti vjetor i NJSBC, kjo Njësi ka si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes ushtrimit të funksioneve të saj. Ndërkohë mbetet për tu konsoliduar NJSBC e ngritur pranë Fakultetit të Biznesit e cila është ende në hapat e para të organizimit të saj, nëse kjo njësi do të vazhdojë funksionin e saj edhe përtej procesit të akreditimit.
- (2) Për sa i përket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitorues, edhe pse janë përmendur në Raportin vjetor të NJSBC, nuk ka një analizë të mirëfilltë të tyre për të kuptuar çfarë është vlerësuar dhe si ka qënë ecuria e vlerësimit, nëse janë marë masa apo ka ndonjë plan aksioni për to. Në fakt ato analizohen dhe perfshihen në Reportet vjetor të Departamentit. Sugjerohet që rezultatet e mekanizmeve të vlerësimit dhe të sigurimit të përfshihen në një proces vetëvlerësimi të stafit akademik. Po ashtu të integrohen raportet vjetore departamentale në atë të NJSBC-së.
- (3) Në raportet vjetore të Departamentit dhe në raportin e NJSBC duhet të përfshihet një analizë e detajuar e matësve sasior dhe të adresohen mangësitë e ndryshme për përmbushje".

#### Komenti i GVB:

*Në vlerësimin e dhënë për të gjitha kriteret e Standardit VI.2, GVJ nuk i është referuar tërësisht realitetit dhe dokumenteve. Njësitë e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë janë ngritur dhe funksionojnë prej kohësh tashmë, ndërkohë që Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës përdor edhe mekanizma të përcaktuar qartë për vlerësimin periodik të programeve të studimit. Njëkohësisht, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matës e vlerësues për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.*

*Të tilla janë anketimi periodik i studentëve, formulari i vlerësimit të stafit akademik nga studentët, analizat periodike të njësisë bazë dhe njësisë kryesore, raportet e vlerësimit të brendshëm, raportet*

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





e vlerësimit të stafit akademik, analizat vjetore të programeve të studimit. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i mbështet të gjitha këto me dokumentet e bashkangjitura, të cilat dëshmojnë veprimtarinë tonë disavjeçare në këto drejtime.

Autoritetet drejtuese të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës gjithnjë kanë marrë dhe marrin rezultatet e mekanizmave të tillë, duke i përdorur për përmirësimin e vazhdueshëm. Ndryshimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave të programeve të studimit dhe i silabuseve të lëndëve përbëjnë dëshmi të reflektimit ndaj rezultateve të marra.

**GVJ:** Raporti në këtë pikë nuk ndryshon. GVJ mendon bazuar në evidencat e vëna në dispozicion si edhe takimet e zhvilluara në institucion se NJSBC ka nevojë të përmirësojë mënyrën e saj të funksionimit. Ndryshimet, e syllabuseve, sipas referimeve gjatë takimit me perfaqësuesin e vetëm të NJSBC, nuk është inicuar nga kjo zyrë dhe për më tepër ato janë të pa firmosura nga ky përfaqësues. Mënyra e kryerjes së vlerësimeve është në konflikt interesi, ku shefi i departamentit dhe dekani miraton dhe kontrollon programet e veta. Nevojitet (në zbatim të Rregullores së UAMD dhe ligjit për arsimin e lartë) një organ i pavarur (zyra e NJSBC) për të ushtruar këtë funksion, jo vetëm për programet e studimit por edhe zyrat mbështetëse si Burimet Njerezore, Biblioteka, Alumni, etj.

- **Fusha VI Standarti VI.3 Kriteri 1-4.**

Konstatimi i GVJ:

“GVJ në brendësi të shpjegimit të këtyre kriterëve citon se:

(1) Në UAMD përveç NJSBC, departamentit të menaxhimit si njësi bazë e ofrimit të programit të studimit, angazhohen edhe zyrat e tjera të institucionit, si ajo e Projekteve dhe Marredhenieve me Jashtë dhe zyra e Keshillimit të Karrierës, (*Referuar informacionit të marre gjatë vizitave në institucion*).

Rekomandohet të integrohen gjetjet e zyrave mbështetëse në raportet dhe analizat vjetore departamentale dhe të fakultetit për të garantuar procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore dhe objektivat e programit të studimit.

(2) Si pjesë e rëndësishme e filozofisë së UAMB por edhe në Manualin e Cilësisë, shprehet që studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet përfaqësuesve janë pjesë e Senatit, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të UAMD këshillave studentore, Komisionit të Etikes, etj, por në praktike, u vu re se nuk ka përfaqësues të studenteve të cilët të jenë pjesë e sigurimit të cilësisë së programit. (Evidenca nr.70 dhe *Kreu VI mbi Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin, i Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve*). Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.

Komenti GVB:

GVB e konsideron vlerësimin e GVJ për dy kriteret e para të Standardit VI.3 si përgjithësisht të drejtë dhe në harmoni me realitetin pranë Departamentit të Menaxhimit, Fakultetit të Biznesit dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

GVB gjykon se GVJ ka shkuar përtej përcaktimit të Kriterit 3, duke vënë në dukje një mangësi që Kriteri 3 nuk e kërkon dhe duke dhënë një rekomandim që ul vlerësimin e përgjithshëm. Kriteri 3 ka në thelb përdorimin e metodave të drejtpërdrejta për garantimin e mbarëvajtjes së programit mësimor, ndërkohë që vlerësimi i dhënë vë në dukje përdorimin e metodave të tërthorta. Pavarësisht se në vlerësim renditen disa nga metodat e drejtpërdrejta që përdoren në Universitetin “Aleksandër



Moisiu” Durrës, prezantimi i tyre si pjesë e metodave të tërthorta bën që vlerësimi për këtë kriter të rezultojë jo pozitiv. GVB është i mendimit se vlerësimi për këtë kriter duhet të jetë më pozitiv pasi si Departamenti i Menaxhimit, ashtu edhe njësitë e tjera të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zbatojnë metodat e drejtpërdrejta për garantimin e mbarëvajtjes së programit mësimor, si: vlerësimi i didaktikës dhe i kurrikulës, intervista të drejtpërdrejta, vëzhgime në auditor, testime paraprake dhe përfundimtare, etj.

Ndërkohë, vlerësimi i dhënë për Kriterin 4 të Standardit VI.3 nuk është i duhuri sipas tematikës që ai kriter parashtron. Kriteri 4 ka në thelb përdorimin e metodave të tërthorta për garantimin e mbarëvajtjes së programit mësimor, ndërkohë që vlerësimi i dhënë vë në dukje “se nuk ka përfaqësues të studenteve, të cilët të jenë pjesë e sigurimit të cilësisë së programit”. GVB, në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, ka përcaktuar qartë masën e përmbushjes së këtij kriteri, duke bashkangjitur dokumente mbështetëse, si: anketat periodike të studentëve, pyetësorët për studentët e diplomuar, formulari i vlerësimit të stafit akademik, etj.

Nisur nga vërejtjet e mësipërme, GVB fton GVJ që të rishikojë vlerësimin e dhënë për Standardin VI.3. Në vlerësimin e dhënë, GVJ nuk i është referuar dokumenteve mbështetëse të bashkangjitura në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm.

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. GVJ vlerëson përpjektet maksimale të njërive bazë të ofrimit të programit të studimit, por për garantimin e cilësisë me integritet dhe pavarësi, nevojitet të këtë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve.

- **Fusha VI Standarti VI.4 Kriteret 1-5.**

Konstatimi i GVJ:

“GVJ në brendësi të shpjegimit të këtyre kriterëve citon se:

- (1) Institucioni ka shpërndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet, rektorat) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj, por personeli mbulon njëkohësisht më shumë se një pozicion administrativ, duke mos garantuar pavarësi në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.
- (2) NJSBC pranë Fakulteteve përkatëse përbëhet nga përgjegjësat e çdo departamenti dhe 2 zv/dekanët dhe nuk ka asnjë përfaqësues të studentëve dhe as raporti vjetor i NJSBC qëndrore nuk është firmosur prej ndonjë përfaqësuesi studentësh. Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi”.

Komenti i GVB:

Nga vlerësimet e dhëna për të gjitha kriteret e Standardit VI.4 kuptohet sikur i gjithë procesi dhe sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të jenë të pavarur nga IAL, duhet që IAL të mos i kontrollojë apo manipulojë ato. Në këndvështrimin e GVJ, në Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, duket sikur IAL nuk është i interesuar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe kjo gjë mund të arrihet vetëm përmes angazhimit palëve të pavarura.

Bazuar në frymën dhe germën e Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet e tjera nënligjore, përfshirë këtu edhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, sigurimi i brendshëm i cilësisë përfaqëson një sistem që shtrihet në mënyrë kapilare në të gjithë IAL dhe një proces ku marrin pjesë të gjithë.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë është pjesë përbërëse e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe mishërohet në çdo strukturë të tij, sepse vetë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është pala më shumë e interesuar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Të gjitha kriteret e Standardit VI.4 theksojnë nevojën dhe rëndësinë e gjithëpërfshirjes në sistemin dhe proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar nga GVB, vë në dukje se si **de jure** me anë të dokumenteve dhe rregulloreve të adoptuara nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe njësitë përbërëse të tij, ashtu edhe **de facto** me anë të strukturave gjithëpërfshirëse të ngritura në të gjitha nivelet e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, përfshirja e të gjithë palëve është fakt i vërtetë dhe funksional.

**GVJ:** Raporti në këtë pikë **nuk ndryshon**. GVJ vlerëson përpjektet maksimale të nejsive baze të ofrimit të programit të studimit, por për garantimin e cilësisë me integritet dhe pavarësi, nevojitet të këtë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve, gje e cila nuk rezultoi nga takimet në institucion.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Drejtimi i SME-ve”

### I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit MP “Drejtimi i SME-ve”, i ofruar nga Departamenti i Manaxhimit në Fakultetin e Biznesit të UAMD është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehura në planin strategjik të tij.			
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Ai ruan dhe konsolidon vlerat akademike e kulturore kombëtare.			
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konstatoi që ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e UAMD ku në qendër është studenti dhe kjo gjë u konstatua gjatë takimeve me vetë studentët dhe stafin akademik.			
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga konsultimi me dokumentat bazë dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se programi i studimit MP “Drejtimi i SME-ve” është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Ky program është mbështetur në “Strategjinë kombëtare për zhvillim 2016-2021”, dhe perputhet me strukturën e ekonomisë shqiptare. Pas përfundimit të këtij programi studentet paisen me aftësi e kompetenca profesionale në fushën e manaxhimit të biznesit. Por GVJ mendon se kurrikula nevojitet të thellohet specifikisht në problemet e menaxhimit të SME-ve për ti mundësuar studentëve shprehje të veçanta në fushën e drejtimit të SME-ve duke plotësuar dhe nevojat e tregut të punës, në nivel lokal e kombëtar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë	GVJ vlerësoi se ky program studimi është në përputhje e në zbatim me planin strategjik të UAMD. Strategjia e institucionit prek një sërë fushash që kanë të bëjnë me

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



institucionit.	nivelein e mësimdhënies, kërkimin shkencor, specializimin e vazhdueshëm të stafit.			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Bazuar në analizën e dokumentave strategjikë të institucionit, ( <i>Statuti, Plani Strategjik, Rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit</i> ) dhe nga vizita në institucion GJV konstatoi se ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në këto dokumenta. Pra ky program ndjek dhe zbaton misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Megjithatë vihen re disa mospërputhje midis këtyre dokumentave në lidhje me evidentimin e pikave të dobëta të fakultetit, departamentit dhe prioriteteve në planin strategjik institucional, gjë e cila na u sqarua si lapsus nga dekani dhe shefi i departamentit.			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Ky program studimi është në zbatim të VKM nr 41 Dt.24.01.2018. Programi ofrohet nga Departamenti i Manaxhimit, Fakulteti i Biznesit dhe është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të UAMD-së, me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehura në planin strategjik të tij.			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Shqyrtimi i dokumentave bazë dhe vizita në institucion e GJV konfirmojnë se programi i studimit MP “Drejtimit i SME-ve” është hartuar në përputhje zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Ky program është mbështetur në “Strategjinë kombëtare për zhvillim 2016-2021”, dhe përputhet trendet globale të zhvillimit ku sipërmarrja dhe biznesi i vogël zenë një vend të rëndësishëm.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Pas shqyrtimit të dokumentave rezulton se programi i studimit MP, ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë, dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë ata në përfundim të tij dhe këto janë në përputhje me atë që kërkon tregu. Ky program <i>studimi (duke iu referuar dhe rregullores së tij dhe të departamentit)</i> ka qëllim parësor (duke reflektuar atë se çfarë kërkon tregu i punës në këtë sektor) përparatë të specialistëve me njohuri e kompetenca në fushën e drejtimit të SME-ve, të aftë të analizojnë problematikat e SME-ve dhe ofrimin e zgjidhjeve të tyre.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike.	Institucioni ka kryer një studim paraprak tregu përpara hapjes së programit dhe ka bërë disa takime me biznese më pas, por kjo në nivel diskutimesh pasi institucioni nuk disponon të dhëna të analizuar dhe konkluzione konkrete të një studimi të mirëfillt

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





<p>Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>tregu për të parë edhe zhvillimet e pritshme të sektorit të biznesit. Gjithashtu ka disa tregues të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve, ku 50% e tyre janë të punësuar në administratë publike dhe biznese dhe 50% janë të papunë. Rekomandohet të analizohen më tej të dhënat e punësimit dhe përkthehen në strategji për përmirësimin e programit të studimit dhe thithjen e një numri më të madh studentësh.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Përfitimi i dijeve të studentëve të ofruara nga struktura dhe përmbajtja e programit të studimit u përgjigjen nevojave të tregut të punës. Sugjerohet që të riorganizohet apo shtohet grupi i Lëndëve karakterizuese duke përfshirë më tepër lëndë të profilit të drejtimit të SME-ve për të ardhur më në ndihmë formimit profesional të studentëve në këtë fushë specifike të manaxhimit të biznesit, për të lehtësuar punësimin e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është ristrukturuar në vitin 2018 dhe gjatë takimeve me dekanin dhe shefin e departamentit mësuam se kurrikula e rishikuar është bazuar në kurrikula të ngjajshme të ofruara nga vendet e rajonit dhe BE. Megjithatë, GVJ bazuar në verifikimin e tij me kurrikula të ngjajshme të huaja, sugjeron si më lart shtimin e lëndëve specifike të drejtimit të SME-ve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit synon të përgatisë specialist që i përgjigjen kërkesave të tregut të punës në vend dhe jashtë tij. Statuti i UAMD (neni 3, pika 1d dhe neni 4, pika 3a), Rregullorja e Programit (neni 2). Gjatë takimeve në institucion na konfirmuan se rishikimi i kurrikulës është bazuar edhe në shqyrtimin e kurrikulave të ngjajshme me institucione arsimore në vendet e BE-së.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se shumica e studentëve kryejnë praktikën në institucione financiare dhe pak prej tyre pranë bizneseve. Gjithashtu edhe temat e diplomave tentojnë të jenë më tepër në profilin financiar.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Kjo praktikë nuk aplikohet në këtë program, edhe pse UAMD ka disa marrëveshje mobiliteti aktive.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Numri i vogël i studentëve dëshmon të kundërtën për këtë program. GVJ sugjeroi bashkimin e këtij masteri me MP në “Menaxhim Biznes” i ofruar nga Fakulteti i Biznesit, mendim i cili mësuam gjatë takimeve se ishte sugjeruar edhe nga NJSBC e institucionit.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**Standardi I.4**  
**Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ konstatoi se UAMD ka në dispozicion burimet njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të tij. Stafit i Fakultetit është me përvojë dhe i kualifikuar (pjesa me e madhe) në fushat specifike që mbulojnë këtë program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentave dhe vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore, sikurse dhe në takimet me stafin u vu re që rekrutimi i stafit të ri bëhet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi. Sugjerohet një mbajtje me e regullt dhe me të gjithë dokumentacionin perkates të përditësuar.			
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit që akreditohet është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhimit, që është njësia bazë e ofrimit të tij. Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Gjithashtu, emërtimi i këtij programi është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhimit, si njësia bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.			
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N/A			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi I.5**  
**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani,**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<b>palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit njesia bazë përgjegjëse është Departamenti i Menaxhimit, me detyrën për të përmbushur qëllimin e programit. Departamenti mbulon me staf të kualifikuar shumicën e lëndeve/moduleve të programit, për pjesën tjetër angazhon staf nga departamentet e tjera të Fakultetit dhe staf të jashtëm. I gjithë procesi (pra për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit u konstatua që bëhet në mënyrë të koordinuar nga të gjitha hallkat (përgjegjëse dhe drejtuese) e strukturës (organigrames) së UAMD.			
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe praktikave profesionale, GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga IAL dhe takimeve me studentët dhe stafin se UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi, të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave të programit të studimit ( <i>Referuar Marreveshjeve te Bashkëpunimit</i> ).			
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	GVJ konstatoi se në planin mesimor të këtij programi studimi praktika profesionale ze një vend të rëndësishëm, ajo shoqërohet me 6 kredite ECTS dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të ketë kontakte me tregun e punës etj. UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi të cilat shfrytëzohen për praktikat profesionale të studentëve. ( <i>Referuar Marreveshjeve te Bashkëpunimit</i> )			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Bashkëpunimi ndërmjet UAMD dhe bizneseve për bërjen të mundur realizimin e praktikave profesionale të studenteve të këtij programi studimi, behej nepermjet marreveshjeve por edhe me ane te kerkesave te vecanta. Gjithsesi u konstatua se institucioni/biznesi ku studentet kryejne praktiken eshte e lidhur me fushen e studimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	N/A			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njesia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Institucioni kryen analiza periodike të përfitimeve nga marrëveshjet dhe i përfshin këto analiza në raportet e departamentit, fakultetit dhe Zyrës së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi ( <i>L. 80/2015 &amp; VKM Nr. 41 datë 24.01.2018</i> ). Ky program është organizuar me lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbyllëse.
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimit synohet arsimimi profesional dhe shkencor i studentëve në fushën Drejtim i SME-ve. Programi i studimit siguron një përgatitje të mjaftueshme që studentët të përshtaten në tregun e punës duke u bazuar në njohuri që ndërthurin disiplina humane me ato sasiore.
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit të ciklit të dytë ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve me njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe praktike në fushën Drejtimi i SME-ve. Programi pretendohet nga IAL se është hartuar bazuar në studimin e kryer për nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit.
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Duke vlerësuar dosjen e këtij programi studimi si dhe duke u bazuar në diskutimet e realizuara gjatë vizitës në IAL dhe komunikimit me pedagogët e lëndëve të këtij programi, mund të konkludojmë se ky program studimi synon që të zhvillojë studentët me njohuri profesionale, të nevojshme për fushën Drejtimi i SME-ve.
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Ky program studimi është hartuar duke marrë në konsideratë elementët e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe duke u shprehur në planin mësimor dhe programet mësimore të lëndëve të këtij programi studimi.  Duke u bazuar në dosjen e këtij programi studimi dhe konstatimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, mund të konkludojmë se ky program studimi përmban elementët e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij. Kurrikula e programit të studimit hartohet nga departamenti dhe më pas miratohet nga Dekani i FB-së si dhe nga Senati i UAMD-së.

<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi MP Drejtimi i SME-ve i ka lëndët të grupuara në lëndë të detyrueshme, karakterizuese dhe ndërdisiplinore. Programi i studimit ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar modulet në përputhje me kategoritë e përcaktuara në VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.5) dhe ka përcaktuar gjithashtu edhe ngarkesën përkatëse në kredite për secilën kategori të veprimtarive formuese brenda këtij programi studimit duke respektuar peshën e përcaktuar në VKM nr.41 dt. 24/01/2018.</p>			
<p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Më poshtë paraqitet situata e klasifikimit të lëndëve në këtë program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëndë bazë (përgatitja metodologjike dhe kultura e përgjithshme) - kredite (8.3%)</li> <li>• Lëndë karakterizuese, (formim specifik) - kredite (35%)</li> <li>• Lëndë ndërdisiplinore (nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje) –kredite (30%)</li> <li>• Lëndë plotësuese (praktika profesionale) –kredite (10%)</li> <li>• Detyrime përmblyëse (përgatitja e tezës së diplomës) – ... kredite( 16.7%)</li> </ul> <p>Programi i studimit MP “Drejtimi i SME-ve” përmban 7 lëndë (44 kredite ECTS) dhe organizohet në 2 semestra.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.2</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>UAMD përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera të përcaktuara në statutin e tij sipas ligjit në fuqi (L. 80/2015, Neni 22, pika 1). Gjithashtu, në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015, Neni 22, pika 2), FB është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit MP “Drejtimi i SME-ve”.</p> <p>Kjo njësi kryesore përbëhet nga 5 Departamente në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi. Përbërja e FB-së jepet si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Shkencave Ekonomike</li> <li>2. Departamenti i Menaxhimit;</li> <li>3. Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;</li> <li>4. Departamenti i Marketingut;</li> <li>5. Departamenti i Turizmit;</li> </ol> <p>Departamentit është njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, dhe është i organizuar në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 -</p>



	<p><i>Neni 22, pika 3, Neni 25, pika 1).</i></p> <p>Departamenti përbëhet nga 14 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE). 6 personel akademik me kontratë dhe 1 personel ndihmës akademik (<i>L. 80/2015 - Neni 57, pika 1).</i></p> <p>Numri i PAE të angazhuar me programin MP “Drejtimi i SME-ve” nuk ka plotësisht përputhje me detyrimet në fuqi (<i>L. 80/2015 - Neni 25, pika 4</i>), pasi ka pedagog pa grada shkencore që janë të angazhuar në mësimdhënie në këtë degë gjatë 3 viteve të fundit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit si njësia kryesore e këtij programi bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si edhe ofron programe studimore të nivele të ndryshme (<i>L. 80/2015, Neni 23, pika 1</i>) në 3 cikle studimi: cikli i parë (Bachelor), cikli i dytë (Master i Shkencave dhe Master Profesional) dhe cikli i tretë (master ekzekutiv dhe doktoraturë). Këto programe ofrohen nga FB i përbërë nga 5 njësi bazë funksionimi i të cilave përcaktohet në statutin e UAMD-së.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, DM ka në përbërjen e saj 14 anëtarë si personel akademik efektiv dhe 1 anëtarë si personel ndihmës akademik. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi kërkohet të përmbushë detyrimet në përputhje me ligjin në fuqi (<i>L. 80/2015 - Neni 59, pika 6</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Bazuar në të dhënat përkatëse (<i>Tabela e stafit ne Fakultet, Departament dhe ne programin e studimit per vitin akademik 2019-2020</i>), rezulton se personeli akademik i DM-së ka 14 PAE, nga të cilët: 4 janë në kategorinë Profesor (Prof.Asoc.Dr.), 7 janë me Gradën Shkencore “Doktor Shkencash” dhe 3 janë me MSC, si dhe 6 PAK nga të cilët: 1 Profesor (Prof.Asoc.Dr), 1 “Doktor Shkencash” dhe 4 Msc.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Në bazë të nevojave vjetore, DM përveç personelit akademik të brendshëm, angazhon edhe personel të jashtëm akademik. Sipas diskutimit gjatë vizitës në IAL, analiza dhe planifikimi për PAE, PAK dhe staf akademik të ftuar bëhet nga njësia bazë në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga Dekanati dhe nga Rektori. Nga GVJ u kërkuan të dërgohen evidenca të analizave dhe diskutimeve të bëra në njësinë bazë për shpërndarjen e ngarkesave mësimore dhe analizën dhe planifikimin e nevojave për PAE dhe PAK. Për këtë kërkesë të GVJ-së u dërgua një evidencë por që në brendësi të saj nuk përmban atë çfarë u pretendua se kanë dhe duhej të kishin.</p> <p>GVJ sipas evidencës 66 (<i>Te dhena Tabelore me ngarkesen e plote mesimore te stafit akademik, ne te gjitha programet</i>), konstaton se bazuar në dokumentin që pasqyron ngarkesën mësimore të personelit akademik të njësisë bazë që mbulon këtë program studimi ka qenë mesatarisht nga 497.7 orë për çdo PAE në vitin 2013-2014 ku ka edhe PAE me mbi 800 orë mësimore, ndërkohë që situata paraqitet në vitin</p>

	<p>akademik 2016-2017 për çdo PAE ka pasë mesatarisht 386 orë; në vitin akademik 2017-2018 për çdo PAE ka pasë mesatarisht 314 orë; në vitin akademik 2018-2019 për çdo PAE ka pasë mesatarisht 305 orë.</p> <p>Sipas Evidencës Nr.113 (<i>Tabele me te dhenat financiare mbi koston e Programit MB</i>), në sistemin e ASCAL për vitin akademik 2017-2018 ka në total 360 orë mësimore, nga të cilat 37.5% kryheshin nga PAE pa grada shkencore dhe 37.5% kryheshin nga PAK të cilat përbënin rreth 65.5% të totalit të kostos për orët mësimore të këtij programi studimi. Ndërkohë që vetëm 25% janë kryer nga PAE me grada shkencore, ndërkohë që detyrimi është jo më pak se 70% të kryhen prej kësaj kategorie. Për vitin akademik 2018-2019 së pari janë shtuar orët mësimore në total dhe për këtë program studimi evidentojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ka pasur 445 orë mësimore në total;</li> <li>• 175 orë ose 39.3% të totalit janë kryer respektivisht nga PAE pa grada shkencore (kjo në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi);</li> <li>• 60 orë ose 13.5% të totalit janë kryer respektivisht nga PAK të ftuar, por këta përbëjnë rreth 32% të totalit të kostos për orët mësimore të këtij programi studimi;</li> <li>• 210 orë ose 47.2% të totalit janë kryer respektivisht nga PAE me grada shkencore (për programin master kjo duhet të ishte jo më pak se 70% për të qenë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi).</li> </ul> <p>GVJ konkludon se në IAL nuk kryhen diskutime dhe analiza për ngarkesën në këto programeve mësimore duke sjellë si pasojë mos respektim të cilësisë dhe standardeve të përcaktuara që mësimi të kryhet vetëm nga PAE që kanë grada shkencore për jo më pak se 70% të ngarkesës mesimore, si edhe për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie nevojitet zbatimi i <i>Udhëzimit Nr.29, datë 12.09.2018 të MASR</i>, pasi evidentohet se pothuajse të gjithë PAE-të kanë marrë orët suplementare prej 200 orë mësimore në auditor, përveçse orëve të tjera të punës për angazhime të tjera në IAL.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>RVB në këto kriteret shprehet se mbështetur në Rregulloren e programit të studimit, Departamenti i Menaxhimit cakton një koordinatör për programin e studimit që është përgjegjës për koordinimin e përgatitjes së materialeve pedagogjike, të praktikave profesionale dhe udhëzimeve për temën e diplomimit duke siguruar dhe mbikqyrjen e tyre. Raportimet dhe koordinimet i bën me Përgjegjës të Departamentit të Menaxhimit, e cituar kjo edhe në nenin 15 të Rregullores së Departamentit të Menaxhimit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike të drejtuesit të njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në kohën e planifikuar për diskutim me koordinatörin e këtij programi u paraqit Përgjegjësja e Departamentit të Menaxhimit</p>

	<p>duke u shprehur se detyrën e koordinatorit të programit të këtij studimi e mbulon vetë Përgjegjësi i Departamentit duke depozituar një interpretim ligjor me evidencën nr. 2, në rubrikën “Vizita në Institucion dhe dokumentacioni i marrë gjatë vizitës”.</p> <p>Dualizmi mes RVB-së dhe Rregullores së Departamentit të Menaxhimit nga njëra anë dhe nga ana tjetër pretendimit gjatë takimit në IAL dhe interpretimit të bërë, evidenton paqartësi në njohjen dhe ndarjen e detyrave në Departamentin e Menaxhimit.</p> <p>Në përfundim GVJ risjell në vëmendje të IAL-së se detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë apo person përgjegjës duhet të jenë të përcaktuara dhe në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi, përndryshe zbatimi i tyre do të vijojë të ndeshë të tilla situata të mos nohjes së detyrave dhe përgjegjësive që ka secili dhe si rrjedhim mosmbarëvajtjen e këtij program studimi në UAMD.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Departamenti Menaxhimit në Fakultetin e Biznesit në UAMD është njësia bazë mësimore-kërkimore për organizimin e programit të studimit MP në “Drejtimi i SME-ve”. Ai disponon dokumentacionin e plotë për këtë program studimi ku përfshihen: Kurrikulat e programit të studimit; Planin mësimor si edhe Syllabuset e lëndëve (pavarsisht se këto të fundit nuk janë të gjitha sipas standardeve të kërkuara dhe të shoqëruara me firmat respektive.). Kurrikula e këtij programi studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. (VKM nr.41 dt. 24/01/2018), statutin e UAMD-së si edhe neneve 35 dhe 38 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit.</p> <p>Kurrikula përmban 7 lëndë të shpërndara në 2 semestra. Secila lëndë vlerësohet me numrin e krediteve përkatëse ( 5, 6 apo 7 ECTS). Për llogaritjen e krediteve është marrë parasysh ngarkesa e çdo moduli ku një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.1.b). Totali i krediteve plotëson numrin total të krediteve prej 60 ECTS.</p> <p>Plani mësimor përfshin elementët e mëposhtëm në përputhje me VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.6). Emërtimin për secilin modul</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	

	<p>të këtij programi studimi për çdo kurs, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës. Numri i krediteve për çdo modul varion nga 5-7 ECTS. Orët në total për secilin modul variojnë nga 65-90 orë dhe raporti i orëve - leksion/seminar në varësi të llojit të lëndës ku kryeson raporti 2:1 dhe 2:2. Çdo modul ka detyrimet e tij (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi, detyra kontrolli). Vlerësimi i dijes së studentit varion nga 20- 40% gjatë vitit. Ndërsa mënyra e kontrollit të dijeve për çdo modul në provimin final kryesisht e ndeshim si provime me shkrim pothuajse për të gjitha lëndët.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Statuti dhe kuadri rregullator mbi të cilat funksionojnë njësitë e IAL-së pasqyrojnë qartë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me ligjin në fuqi (<i>L. 80/2015, Neni 76, 89, VKM, 2.7 kuotat e pranimit</i>). Ndërsa kriteret finale të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë të studime përcaktohen nga MASR për vitin akademik përkatës.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për Programin MP në “Drejtimit i SME-ve”, programi i lëndës që përdoret për hartimin e syllabuse-ve është modeli i përcaktuar në <i>VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca nr.2)</i>. Pavarësisht përpjekjeve që syllabuset e lëndëve të këtij program studimi të respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve të <i>VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (shtojca nr.2)</i>, evidentohet se pothuajse të gjitha ato nuk respektojnë plotësisht elementët përbërës të modelit. Vlen të përmenden disa elementë për përmirësime, të tilla si: formatimi standard dhe i unifikuar; titullari i lëndës; firmosja prej personave respektivë; literatura e 5 viteve të fundit në shqip, etj.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Kurrikula e Programin MP në “Drejtimit i SME-ve” ka pësuar ndryshime pas vitit 2017. Këto ndryshime janë kryer duke patur si qëllim përmirësimin e programit në përputhje me kërkesat e tregut dhe duke marrë parasysh zhvillimit e fundit. Nga takimi i realizuar me personelin akademik që japin mësim në këtë program studimi si edhe drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë u informuam se çdo fillim viti diskutohet dhe bëhen ndryshimet që gjykohen të nevojshme në programet e lëndëve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të**

punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit përmban një ngarkesë mësimore të hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore duke u shtrirë studimet në një vit akademik të ndarë në 2 semestra dhe të organizuar mbi bazën e lëndëve në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi (VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, Pika 2.1.d). Ngarkesa mësimore javore në auditor në lidhje me leksione, seminare, ushtrime, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe praktika të zhvilluara në auditor, është deri në 25 orë mësimore 50-minutëshe.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese të Programit MP “Drejtimi i SME-ve”, mundësojnë thellimin dhe aftësimin e studentëve në fushën e menaxhimit të SME-ve duke i dhënë atyre aftësi në krijimin e sipërmarrjeve dhe menaxhimin e tyre me qëllim rritjen e jetëgjatësisë dhe të ardhurave të qëndrueshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>Në takimet me pedagogët e angazhuar në Programin MP “Drejtimi i SME-ve” u shprehën se orët e mësimin në auditor (leksione, seminare, ushtrime apo praktika në laboratorë) zhvillohen në formë interaktive ndërmjet pedagogut dhe studentit, ku pedagogët paraqesin shembuj të ndryshëm për të mbështetur pjesën teorike dhe raste studimi të ndryshme për të stimuluar mendimit krijues dhe kritik të studentit. Këto u konfirmuan edhe nga takimi me studentët gjatë vizitë në IAL por jo për të gjitha lëndët.</p> <p>Nga takimi i realizuar me pedagogët pyetëm dhe morëm përgjigje prej tyre lidhur me angazhimin mbresëlënës që kanë studentët në konferenca studentore dhe ata u shprehën se ato realizohen së pari në kuadër të detyrës së kursit, e cila i aftëson ata për të punuar në grup, për të ndarë punën, për të komunikuar në mënyrë elokuede, si edhe i mëson sesi duhet të mbledhin dhe të analizojnë informacion për çështje të caktuara.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura, organizimi dhe programi studimit duke përfshirë natyrën e moduleve të ofruara, ngarkesën e tyre në ECTS, raportin e aspekteve teorike dhe aplikimeve të mundshme praktike, është në përputhje me profilin e këtij programi master profesional dhe përmban disa karakteristika në emërtim që e bëjnë të veçantë programet e tjera të masterave profesional.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike. Gjithashtu, për specifikën që paraqet, tenton të mbulojë nevojat në tregun e SME-ve në Shqipëri dhe për më tepër në qarkun e Durrësit.</p> <p>Ngarkesa në orë mësimore prej 1500 orësh dhe me kredite prej 60 ECTS, tregon se ky program i përmbahet përcaktimeve ligjore për</p>



	këtë cikël studimi dhe e përafuron atë me programe të tjera të ngjashme ndërkombëtare.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Referuar RVB-së është e pamundur të marrësh informacion dhe përgjigje për kriteret e RVJ-së, për këtë arsye ju drejtuam pyetje për qartësim gjatë takimeve me anëtarët e GVB-së dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi. Stafi i departamentit u shpreh se ata analizonin ecurinë e çdo programi studimi duke përfshirë në to mendimin dhe opinionin e të gjithë personelit akademik.</p> <p>Pavarsisht se përgjithësisht, syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi përmbajnë formatin dhe elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve të VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (shtojca nr.2), ato kanë disa mangësi.</p> <p>Anëtarët e GVJ-së konstatuan se: të gjithë syllabuset e depozituara në sistemin e ASCAL ishin dokumenta në word pa firmën e titullarit/lektorit të lëndës dhe të përgjegjësit të departamentit; ka lëndë të cilat nuk kanë për titullar PAE me grada të kategorisë Profesor; ka module që kanë nevojë të përditësojnë literaturën bazë dhe rekomanduese duke qënë se shkon përtej harkut kohor të 5 viteve të fundit.</p>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Programi MP në “Drejtimi i SME-ve” ka si fokus marrjen e njohurive bazë mbi metodat dhe parimet për formimin e shprehive të veçanta në këtë fushë. Studentët fitojnë aftësi dhe kompetenca të nevojshme lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve, funksionet e marketingut, financës, menaxhimin e burimeve njerëzore, etj.			
<b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi MP “Drejtimi i SME-ve” si programi i studimit të ciklit të dytë kujdeset që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme profesionale për të ndjekur trajnime të tjera të thelluara profesionale apo Master Shkencor.			
<b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Zhvillimet e reja në tregje kanë bërë të nevojshme përshtatjen e këtyre kurrikulave. Për rrjedhojë në kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë. Drejtuesit e njësive dhe pedagogët shprehën se kanë kryer studim tregu i cili ka patur si qëllim të identifikojë se cilat janë njohuritë, aftësitë apo kompetencat që kërkojnë bizneset nga ekspertët e rinj apo nga studentët e diplomuar, si punonjës potencial në tregun e punës. Rezultatet e këtyre studimeve janë reflektuar në ndryshimet e mundshme në kurrikul apo në syllabuset e lëndëve.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Referuar RVB-së nuk është e pamundur të marrësh informacion dhe përgjigje për kriteret e RVJ-së për këtë standard, për këtë arsye ju drejtuam evidencave dhe pyetje gjatë vizitave në IAL me qëllim qartësimin e plotësimin të kriterëve.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>DM përbëhen nga 14 anëtarë të personeli akademik me kohë të plotë, 6 personel akademik me kohë të pjesëshme dhe 1 anëtar i personelit ndihmës akademik. Sipas listës së personelit akademik të programit të studimit, rezulton se të angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2019-2020, janë 8 personel akademik nga të cilët 5 PAE dhe 3 PAK.</p> <p>Sipas të dhënave për vitin aktual (2019-2020) të cilat gjenden në hapin “Vizita në insitucion dhe dokumentacioni i marrë gjatë vizitës” në evidencën me titull “Tabela e stafit në Fakultet, Departament dhe në programin e studimit për vitin akademik 2019-2020..pdf” lista e lektorëve të përfshirë në këtë program studimi nga DM, departamente të tjera të FB-së, dhe PAK të ftuar kanë të gjithë grada shkencore.</p> <p>Por, sipas Evidencës Nr. 113 të depozituar nga IAL për akreditim në sistemin e ASCAL për vitin akademik 2018-2019 për këtë program studimi evidentojmë se nga 445 orë mësimore në total, 175 orë ose 39.3% të totalit janë kryer respektivisht nga PAE pa grada shkencore (kjo në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi) dhe vetëm 210 orë ose 47.2% të totalit janë kryer respektivisht nga PAE me grada shkencore dhe 60 orë ose 13.5% të totalit janë kryer respektivisht nga PAK të ftuar.</p> <p>Pavarsisht se duket se raporti është korrekt për raportin e orëve mes PAE dhe PAK, GVJ konstaton se kategoria e PAE me grada shkencore (të cilët japin vetëm 47.2% të orëve mësimore) duhet të jepte jo më pak se 70% të orëve mësimore për të qenë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.</p> <p>Në përfundim, GVJ evidenton se Personeli Akademik Efektiv që është angazhuar në mësimdhënie në Programin MP “Drejtimi i SME-ve” në 39.3% të orëve mësimore nuk kanë një gradë më lartë sesa cikli i studimit ku japin mësim. Kjo është kryer në kundërshtim me Ligjin 80/2015 - Neni 59, pika 6. Megjithatë sipas evidences shtesë që u dha gjatë vizitës në IAL është shprehur që për vitin aktual akademik nuk do të ketë asnjë PAE pa grada shkencore në këtë program mësimor. Kjo ngelet për tu vlerësuar në të ardhmen.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e	Fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik të

<p>përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përgjithësisht kanë bërë përpjekje të jenë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik të këtij programi del në pah angazhimi i personelit për të zhvilluar specializime në fusha studimi që mund të përkojnë me fushat që ata mbulojnë në kurrikulën e programit të studimit.</p> <p>GVJ evidenton se ka shumë vend për përmirësim lidhur me rritjen e cilësisë akademike të kandidatëve fitues gjatë procesit të rekrutimit të Personelit Akademik Efektiv të cilët më pas angazhohen në mësimdhënie në Programin MP “Drejtimi i SME-ve”.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar kurrikulës së studimit rezulton se studentët gjatë semestrit të 2-të zhvillojnë praktikën profesionale dhe paralelisht përgatisin temën e diplomës. Natyra e këtij programi studimi kërkon kryerjen e praktikës profesionale pranë kompanive të ndryshme, kryesisht të madhësisë së SME-ve. Për t’i dhënë mundësi studentëve për të kryer praktikën profesionale, njësitë mbështetëse si Qendra e Karrierës dhe Alumni, kanë mbështetur njësinë bazë dhe atë kryesore për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me SME të ndryshme.</p> <p>Referuar diskutimit me studentët e këtij programi gjatë vizitës në IAL, evidentohet se ata kryesisht e gjejnë vet vendin ku të kryejnë praktikën profesionale. Procesi i sigurimit të praktikave profesionale të përshtatura me programin specifik mbart vështirësi për çdo IAL, pavarësisht punës së bërë prej tyre për krijimin e një bashkëpunim sa më të mirë me aktorët e tregut të punës.</p> <p>Zhvillimi i punimit të diplomës kryhet paralelisht gjatë periudhës së praktikës profesionale. Studenti supervizohet nga pedagogu udhëheqës gjatë periudhës së zhvillimit të punimit të diplomës. Kjo marrëdhënie vazhdon në çdo fazë të procesit të mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe analizës së tyre si dhe në shkrimin e finalizimin e materialit të diplomës.</p> <p>Nga komunikimi gjatë vizitës në IAL me PAE-të e FB rezultoi se aktiviteti i tyre kërkimor është i mbështetur edhe nga bashkëpunimi me studentët e këtij programi në kuadër të punimeve që ata realizojnë.</p> <p>Gjithashtu, nga komunikimi gjatë vizitës në IAL me studentët, rezultoi se ata janë në komunikim të vazhdueshëm me pedagogët e tyre përmes platformës elektronike edhe komunikimit ballë për ballë me pedagogun udhëheqës, pedagogun e lëndës, etj, për çdo problematikë që mund të hasin gjatë procesit mësimor në këtë program.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton</p>	<p>Studentët e këtij programi studimi nuk kanë orë specifike që të kenë</p>

angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	nevojën e personelit ndihmësimor-shkencor. Megjithatë stafi mbështetës i FB ishte gjithmonë disponibël për çdo nevojë të tyre nëse do të nevojtej.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.6</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbytjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Sipas RVB-së, strukturat përgjegjëse të studimit kryejnë përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut duke realizuar studimin e tregut në fushën “Drejtimi i SME-ve” si edhe bashkëpunojnë me aktorët e tregut.  Gjithashtu, sipas diskutimeve gjatë vizitave në IAL, nga drejtuesit e njësive na u bë me dije se ata bashkëpunojnë me aktorë nga tregu i punës dhe konsiderojnë propozimet e tyre.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	IAL përmes takimeve dhe komunikimit të vazhdueshëm me studentët edhe përmes pyetësorëve i përfshin ata në përmirësimin e programit të studimit MP “Drejtimi i SME-ve”.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	IAL përmes ALUMNI vijon të mbaj kontakte me studentët e diplomuar dhe përpiqet të marr opinionet e tyre për përmirësimin e programit të studimit. Kontributi i të diplomuarve u evidentua edhe gjatë vizitës në IAL ku student të mëparshëm të diplomuar ishin aktiv në shprehjen e opinionëve të tyre dhe të konfirmonin bashkëpunimin që kishin pasë me strukturat e IAL-së për këtë program studimi.			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Gjithashtu, gjatë diskutimit në vizitat në IAL përfaqësuesit e IAL u shprehën për bashkëpunimin e ngushtë që ata kanë me institucionet publike dhe ato të pushtetit vendor duke u kujdesur për krijimin e konferencave dhe temave të studimit me focus në çështjet vendore dhe zhvillimin e SME-ve në qarkun e Durrësit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstatoi se UAMD ka një udhëzues për kualifikimin e stafit akademik. Pedagogët njiheshin me Ligjin aktet nënligjore dhe udhëzimet e MASR për IAL, me Statutin e institucionit, Rregulloren e Fakulteteve, departamenteve dhe programeve të studimit. Stafit akademik është pjesë e marrëveshjeve të mobilitetit të cilat janë zbatuar edhe për stafin e fakultetit ekonomik me synim rritjen profesionale të tyre nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me institucionet e huaja. <i>(Evidenca 52. Te dhenat për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimit shkencor për anetaret e departamentit në 5 vitet e fundit’; 58. Tabele përmbledhese me të dhëna mbi mobilitete për mesimdhënie të stafit akademik dhe Praktika e Rekrutimit të personelit)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Shqyrtimi i akteve të brendshme të UAMD si dhe i dosjeve personale të pedagogëve nxjerr në pah se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është aktiv në publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore. Puna kërkimore dhe botimet lidhen me fushën kryesore të studimit të këtij programi. Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik monitorohet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës. Si instrumente përdoret pyetësori me studentët i cili realizohet para provimeve, rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Përgjatë vitit akademik, realizohen kontrolle periodike nga departamenti i Menaxhimit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve <i>(Rregullorja e NJSBC, neni 6)</i> , si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakëkanqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit <i>(parashikuar në Rregulloren e Fakulteti të Biznesit, neni 83)</i> Por sugjerohet që perfundimet tju bëhen të ditura dhe studentëve pa cituar emra të përveçëm.
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e	Strukturat përgjegjëse (njësia bazë dhe kryesore) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë. Këto rezultate fillimisht diskutohen në një mbledhje të hapur

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





vlerësimit.	departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga takimet në institucion konstatuam se Fakulteti i Biznesit përdor mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Pyetësi i studenteve përdoret si mjet për të evidentuar dhe vlerësuar shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rastet e specifikuar si pozitive nga studentët bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit. Trajnimet dhe kualifikimet e stafit në përputhje me fushat e studimit si dhe përfshirjen në veprimtari të ndryshme shkencore është njëra nga format e përdorura por edhe mobilitetet në kuadër të marrëveshjeve me institucione arsimore brenda vendit dhe jashtë vendit. <i>(Evidencat 52. Te dhenat për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimet shkencor për anëtarët e departamentit në 5 vitet e fundit; 58. Tabele përmbledhese me të dhëna mbi mobilitete për mesimdhënie të stafit akademik; 79. Model pyetësi mbi ecurinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe 84. Analiza pyetësoreve nga studentët, staf akademik, staf administrativ).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të njohurive në UAMD përfshijnë: leksione dhe seminare të pandara, orë laboratorike, detyra/projekte kursi, praktikë profesionale, tema diplome <i>(Statuti i ri UAMD, neni 72; Rregullore e re UAMD, neni 60; Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 51; Rregullorja e Masterit, neni 9).</i> MP në “Drejtim i SME-ve”, ka 60 kredite në total nga të cilat 26 fitohen në semestrin e parë, 18 në semestrin e dytë, 6 praktika profesionale dhe 10 mikroteza <i>(Evidenca “Riorganizim i Programit MP në Drejtim SME”, “Plani mësimor MP në Drejtim SME”).</i> Sugjerojmë që këto specifika të integrohen edhe në rregulloren e programit të studimit, duke e bërë atë më të personalizuar dhe detajuar.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë të paraqitura në syllabuset dhe programet e lëndëve e moduleve. Format e mësimin teorik e praktik janë: leksionet dhe seminarët të integruara, ushtrimet, praktikat profesionale, vizita studimore pranë

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>bizneseve, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit. Gjithashtu në UAMD organizohen leksione të hapura nga lektorë të ftuar të huaj ose vendas si edhe konkurse apo forma të ndryshme mësimore të parashikuara në Rregulloren e Fakultetit (<i>neni 51</i>) dhe Rregullore e Masterit (<i>neni 9</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Stafi akademik mbështetet nga institucioni për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave. Stafi akademik, ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive, duke bërë një kërkesë paraprake pranë sekretarisë mësimore pasi sallat nuk janë ende të pajisura me projektorë. Të gjithë pedagogët janë pajisur me kompjutera dhe zyrat e tyre me internet. Keto ndihmojnë procesin e mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me objektivat formuese dhe kërkesat aktuale të punëdhënësve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në kete program studimi plotëson kryesisht kriteret ligjore të kualifikimit, pasi ka lektorë të cilët janë ende në proces doktorature. Për lëndët dhe modulet ekzistojnë tekste, leksione dhe materiale të tjera që u vihen në dispozicion studentëve, të mundësuar edhe nga libraria e universitetit. Gjatë vizitave në institucion, u evidentua që aty ishin vetëm një numer i kufizuar i literatures bazë dhe mbështetese dhe botime deri në vitin 2015.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Kontrollat e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga dekanati dhe departamenti identifikojë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësi i studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Orët e mësimi janë interaktive, ku studentët bashkëveprojnë me pedagogët dhe njëri-tjetrin. Nga vizita në institucion mësuam se personeli akademik përpigjet që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo realizojnë konkurse dhe vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimi.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies në UAMD, inkurajimi i diskutimeve dhe debateve gjatë orës së mësimi, vecanërisht inkurajimi i tyre për të marrë pjesë në konferencën studentore (<i>Evidenca nr. 61. Vendim për grupet e punës në Konferencën Studentore 5 qershor 2019</i>) ndihmon studentët në shprehjen e mendimit të tyre dhe krijimit të një autonomie të menduari dhe të gjykuari. Fryma e UAMD ku student vendoset në qendër jo vetëm të aktiviteteve mësimore por edhe atyre shkencore, kulturore e sportive, u jep mundësi pedagogëve që ti lejojnë studentët të diskutojnë më shumë dhe të shprehin hapur opinionet e tyre, duke</p>

	vendosur edhe një marrëdhënie të ndërsjelltë respekti midis tyre, gjë e cila u vu re edhe gjatë vizitave në institucion dhe intervista me studentët.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Godina e re dhe kampusi i ri i UAMD mundësojnë që procesi mësimor e shkencor për programin e studimeve të zhvillohet Brenda të gjithë parametrave moderne. Sipas orarit të mësimi semestral, studentët zhvillojnë mësimin (leksione dhe seminare,) në mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambientet, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi, sistem mbrojtjeje nga zjarri, shërbim, ndihme të shpejtë. ( <i>Rregullorja e Teknologjise dhe Informacionit (neni 4&amp; 5); Rregullorja e Bibliotekes (neni 4&amp;6).</i> )
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve mbeten ende për tu pajisur me kompjutera e projektorë. Kampusi universitar i UAMD ku ndodhet Fakulteti i Biznesit, duke qenë një ndërtim i ri me standarte bashkëkohore teknike, ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m <sup>2</sup> / student.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	UAMD ka pajisur zyrat e personelit akademik me zyra të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. Por nga vizita në godinë dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, GVJ-së iu referua se pika të dobëta në departament mbeten logjistika IT e programet kompjuterike. Gjithashtu, siç e përmendëm edhe më sipër, mbeten ende sallat e leksioneve për tu pajisur me kompjutera e

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	projektorë.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Materialet fizike ofrohen në librarinë e Fakultetit të Biznesit. Biblioteka ofron tituj bazë dhe materiale mbështetëse në shqip si edhe në gjuhë të huaj, por nga vizita në Bibliotekë rezultoi se numri ishte i kufizuar dhe botime të vjetra. Megjithatë, studentët dhe pedagogët mund të aksesojnë artikujt të ndryshëm si material mbështetëse nëpërmjet abonimit që universiteti ka bërë në EBSCO.
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. GVJ sygjeron që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duhet të pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga vizita në Institucion rezultoi që biblioteka nuk përdoret shumë nga studentët.
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Në RVB theksohej për aksesin në librarinë online, por kjo rezultoi se nuk përdorej nga studentët me të cilët GVJ zhvilloi takimin. Universiteti përfshihet në Bibliotekën Dixhitale të mundësuar nga RASH.
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	GVJ konstatoi gjatë vizitave në institucion se UAMD ka salla konferencash dhe ambjente studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre. Gjithashtu në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, janë edhe dy laboratorë të teknologjisë informacionit.
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Platformë online (e-learning) mbetet ende një sfidë e UAMD-së për tu realizuar në të ardhmen.
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	UAMD ofron momentalisht akses në dokumentacionin elektronik vetëm për ciklin e parë të studimeve, ndërkohë po punohet për implementimin e tij në të ardhmen për ciklin e dytë të studimit.
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studenti ka të drejtë të propozojë sipas dëshires se tij tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, të zgjedhë udhëheqësin e tij dhe në bashkëpunim më të, të përcaktojë temën kërkimore që do të realizojë për mbrojtje. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale. Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre,

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	<p>përcaktohen nga departamenti dhe miratohen nga dekani i fakultetit, Rregullorja e Tezes se Diplomimit (<i>neni 2&amp;3</i>), Rregullorja e Diplomimit (<i>neni 5&amp; 6</i>). Gjatë punës kërkimore për arritjen e objektivave të përcaktuara në realizimin e punimit të diplomës, udhëheqësi asiston gjatë gjithë kohës studentin dhe e mbështet atë për përmbylljen me sukses të saj.</p> <p>Gjatë takimeve u referua se një pedagog udhëheq deri në 5 teza masteri.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>“Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë”, që nga muaji Maj 2019, është përgjegjëse për të siguruar cilësinë e programeve të studimit në UAMD dhe përmirësuar vazhdimisht mësimdhënien (<i>neni 81 i rregullores së re në UAMD</i>). GVJ konstatoi pas diskutimeve, se kjo njësi e ka të vështirë të monitorojë të gjitha programet e ofruara nga UAMD. Për këtë arsye dhe si pasojë e nevojave imediate të institucionit për akreditimin e disa programeve studimore njëkohësisht, është ngritur NJSBC pranë Fakulteteve përkatëse ku anëtarë janë shefat e çdo departamenti dhe 2 zv/dekanet. Fakulteti i Biznesit dhe Departamentet, dorëzojnë në Rektorat çdo fund viti akademik, një raport vjetor, i konceptuar si një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë. Ky raport shërbën për të patur një pasqyrë të fakultetit dhe për tu përmirësuar në vazhdimësi. Personi përgjegjës për cilësinë e mësimit dhe kurrikulat në nivel fakulteti aktualisht është Dekani. Ai ndjek dhe kontrollon gjithë veprimtarinë mësimore në Fakultetin e Biznesit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit bëjnë kontrolle të vazhdueshme si edhe diskutime të brendëshme me synim rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Dekani si drejtues i fakultetit dhe Përgjegjësi i departamentit të Menaxhimit, si njësi bazë, duke u mbështetur në kontrollin e vazhdueshëm dhe masave të marra, të leksioneve të hapura të organizuara, si dhe të analizës së vazhdueshme të punës mësimore dhe kërkimit shkencor, krijon frymën e përgjegjësisë individuale të personelit akademik për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi.</p> <p>(Referuar, Rregullorja e Programit, neni 10; rregullorja e Departamentit të Menaxhimit, neni 11; Rregullorja e Fakulteti të Biznesit, neni 21).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë</p>	<p>Leksionet e hapura nga lektorë të ftuar të huaj dhe vendas të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





<p>përgjegjëse mbështetin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>organizuar në UAMD, pjesëmarrja e stafit akademik në projektet e mobilitetit me universitetet e huaja, konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, Konferenca Studentore e organizuar me mbështetjen e stafit akademik, kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Aktivitetet kërkimore-shkencore të pedagogëve duke përfshirë edhe studentët në Konferenca Studentore, zenë një vend të rëndësishëm në fokusin e aktiviteteve të UAMD, me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit trasmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit të Biznesit dhe departamentit të Menaxhimit, kualifikohen brenda institucionit, në zbatim të udhëzuesit të stafit akademik si dhe në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes tryezave të rrumbullakta, diskutimeve, leksioneve të hapura i kanë shërbyer trjanimit të stafit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe të metodave të reja në mësimdhënie</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Ka qënë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik zbatimi i programeve të studimit si dhe transmetimi i metodave të reja në mësimdhënie dhe praktikave mësimore tek studentët. Ky është një detyrim i cili rrjedh nga marrëdhëniet e punës që ka stafi akademik në lidhje me realizimin e procesit mësimor të përcaktuara në kontratën e punës. Në fillim të semestrit pedagogu harton planin kalendar të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, që firmoset nga ai dhe përgjegjësi i departamentit. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e mësimin si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i strukturave drejtuese për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe</p>	<p>Stafi akademik i Fakultetit të Biznesit ka përfutur 6 shkëmbime (<i>Referuar bisedës me Zyrën e Projekteve dhe Marrëdhëniet me Jashtë</i>) në kuadër të projekteve të mobilitetit që ka UAMD. (<i>Evidenca 45.2. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe 75.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	<i>Mobilitetet UAMD).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ mendon se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e programit të studimit. Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së UAMD realizohet nëpërmjet: angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegjumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; detyrave të kursit për problematikën e disciplines; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës. Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet në nivelin Master dhe realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve 0-1000 të cilat konvertohen në nota (4-10). Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara ku ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive së bashku me plotësimin e detyrimeve (detyrave të kursit) vlerësohen me 10%, testimet gjatë vitit (ose provimi ndërmjetëm) me 40% dhe në fund kryhet provimi përfundimtar, i cili vlerësohet me 50%. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita ne institucion konstatoam se pedagogu i lëndës para fillimit te çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit. Gjithashtu i njuh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës. Bazuar në rregulloret e studimeve të UAMD-së, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teroik e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Grafiku i provimeve hartohet nga përgjegjësat e departamenteve dhe miratohet nga Dekani. Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në note. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës pasi nuk ka titullar të modulit, dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Nga verifikimet vizitave në institucion u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e Departamentit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë: Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit dhe vlerësimi përfundimtar. Këto programe miratohen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për zbatimin e këtij kriteri, deri më tani korrigjimet bëhen nga pedagogët pasi sistemi elektronik i përdorur në të kaluarën nuk rezultoi efektiv. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore. Sugjerohet përdorimi i një sistemi elektronik për të rritur transparencën në vlerësim.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Përgjegjësi i departamentit (njëkohësisht edhe koordinator i programit të studimit siç na u prezantua gjatë vizitës në IAL) së bashku me komisionet e lëndëve janë përgjegjese për krijimin e komisioneve të provimit. Në përbërjen e tij ka së paku 3 anëtarë ( <i>Referuar Rregullorja e Fakultetit të Biznesit, neni 70, pika 3</i> ), ku njëri prej tyre është pedagogu nga i cili buron lënda/moduli, dhe që është përcaktuar në syllabus, apo ka të njëjtin profil ose të përafert. Komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi se vlerësimi i njohurive dhe dijeve me shkrim për momentin nuk bëhen në mënyrë anonime. Sugjerohet që fletoret e provimeve të sekretohen.

<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi me studentët GVJ u informua që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, foto, video në orët e fundit të seminareve). Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Komisionet e provimit përbëhen nga të paktën dy pjestarë të stafit akademik të miratuar sipas përcaktimit të rregulloreve. Hartimi i tezave të reja bëhet për çdo sezon provimi si dhe të pakten në dy variante. Personelit akademik që ndjek procesin e provimit u ndalon hyrjen në provim personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të UAMD, me përjashtim të drejtuesit të departamentit apo personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati për të kryer kontrole. Studentëve nuk u lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Studentët që në provim përdorin forma e mjete të palejueshme përjashtohen nga provimi. Përsa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj. Eshtë rritur kërkesa ndaj studentëve që mbrojnë temat e diplomave për të shmangur plagjiaturën.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë proçesit të kontrollit stafi shënon pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i kujdeshëm të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit dhe kontrollohen nga përgjegjësi i departamentit. Rezultatet e provimit hidhen në proceverbale brenda 8 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit, sipas verifikimeve që GVJ bëri në sekretarinë mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve. <i>(Evidenca 13. Rregullorja e Provimeve në Fakultetin e Biznesit).</i> Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe në dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore. Provimet me shkrim të studentëve ruhen nga pedagogu i</p>

	modulit për një periudhë gjashtë mujore pas përfundimit të sezonit të provimeve.			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zvillimit të provimeve ose nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 24 oreve. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjës të departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentit është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjës të Departamentit, që studentit të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studentit thëllon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit.  GVJ konstatoi se Kurrikula e rishikuar përmban më pak lëndë dhe nuk parashikon lëndë të formimit bazë për studentët me formim jo ekonomik.  Sugjerohet të përfshihen lëndë të manaxhimit, marketingut dhe financës me fokus SME-të, si psh. “Sipërmarrja dhe Drejtim i SME-ve”, “Marketingu i SME-ve”, etj, në mënyrë që kurrikula të ofrojë thellim dhe profilizim të studentëve në SME.  Në të kundërt, duke marrë parasysh edhe numrin e vogël të studentëve në hyrje dhe dalje të studimeve të këtij program, sugjerohet shkrimi i këtij masteri dhe bashkimi me masterin MP në “Menaxhim Biznes”.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të	Në zbatim të <i>VKM 41, datë 24.1.2018</i> , Modulet janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmblylëse.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në këtë program studimi organizohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët, si edhe vizita studimore në institucione apo biznese.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtruara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për tju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapsirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut.
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga vizita dhe takimi me studentet, konstatoam se personeli akademik krijon nje klime të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punë kërkimore-shkencore. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. UAMD organizon Konferenca Studentore, ku studentët kanë marrë pjesë me punime shkencore të tyre, rezultat i mëshjejes së vazhdueshme që jep personeli akademik.
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Referuar vizitës në insitucion, rezulton se, shpenzimet e pjesmarrjes dhe të botimit të temave të konferencës studentore sponsorizohen nga projektet që ka institucioni. Gjithashtu, në UAMD organizohen edhe konkurse për projekte dhe ide innovative, dhe realizohen me mbështetje këshilluese nga stafi akademik, por këto sponsorizohen nga vetë studentët. (Evidenca 98. Vendim Departamenti date 11.01.2018 Zhvillimi i konkursit Start Up III) Sugjerohet të shikohet mundësia e mbështetjes financiare nga ana e

	institucionit.			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga takimi ne institucion na u komunikua qe nuk ka pasur interes nga studentët master, për mobilitetin në kuadër të marrëveshjeve që ka UMAD, pasi ata janë edhe në marrëdhënie pune.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.8</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	UAMD ka realizuar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike kryesisht dhe private, ( <i>Evidenca 45. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit; 45.1. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit; 45.2. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; 45.3. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s</i> ), të cilat shfrytëzohen edhe për praktikën profesionale të studentëve të programeve master.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	GVJ konstatoi gjate takimeve me stafin akademik dhe studentët se studentët e masterit profesional në “Drejtim i SME-ve” kryejnë praktikat në institucione kryesisht publike apo financiare (p.sh NOA) dhe shumë pak prej tyre shkojnë pranë bizneseve. Sugjerohet të shtohet lista e bashkëpunimeve me biznese sidomos SME dhe studentët të orientohen më tepër drejt praktikave në SME, në mënyrë që të përfitojnë aftësitë profesionale (të synuara edhe nga vetë program i studimit).			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale përfundon me një raport mbi eksperiencën e fituar. Mbrojtja e saj me sukses shoqërohet me fitimin e 6 krediteve ECTS. ( <i>Evidenca 15. Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit</i> )			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Standardi III.9**  
**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit**

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga verifikimi i GVJ diplomimi studentëve në këtë program studimi bëhet me mbrojtjen e një punimi diplome. Kriteret dhe procedurat e diplomimit përcaktohen në Rregulloren e Programit dhe Fakultetit.  Sugjerohet që punimet e diplomave master të publikohen në faqen e internetit të UAMD.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Struktura përgjegjëse e këtij programi studimi është Departamenti Menaxhimit, i cili sipas rregullores dhe atyre që konstatuam i bën të ditur studentëve kriteret e diplomimit. Për këtë angazhohej stafi akademik. Sipas kriterëve studenti depoziton kërkesën pranë departamentit për tu listuar në listën e studentëve për mbrojtje diplome. Në kërkesë ai parashtron temën e diplomës brenda fushës së studimit dhe propozon pedagogun udhëheqës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat e studentëve, mbi bazën e të cilave harton listën e studentëve që plotësojnë kriteret për të përgatitur një punim diplome dhe udhëheqësin dhe ja paraqet për miratim Dekanit të Fakultetit. Drejtuesit e temave të diplomës për të gjithë studentët e listuar që plotësojnë kriteret, miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Formati i paraqitjes së punimit të diplomës është përcaktuar në rregulloren e departamentit.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	N/A
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Nga takimet me studentet dhe stafin, GVJ konstatoi që udhëheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për përgatitjen e temës së diplomës. Sebashku përgatisin programin e punës së studentit, afatet gjatë të cilave ndihmohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ vlerësoi nga takimet se studentët e programit të studimit, e përdorin shumë pak bibliotekën e institucionit. Labororet e teknologjisë së informacionit kanë mjedise të mjaftueshme dhe kompjutera të cilat studentët e këtij program studimi, mund t'i përdorin për përgatitjen e temave të diplomave.
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo një punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nga verifikimet dhe vizita në institucion u konstatua se pedagogu udhëheqës i temës përgatit metodikën e studimit për realizimin e temës së diplomës dhe mbi bazën e saj organizohet e gjithë puna kërkimore që duhet të kryejë studentin etj, duke i dhënë atij të gjithë asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës nga fillimi i kërkimit deri në shkrimin e raportit të punimit, duke garantuar në këtë mënyrë cilësinë e tij. Gjithashtu, udhëheqësi në përfundim të punimit harton një raport të shkurtër me anë të të cilit e miraton atë, ose në rastet kur studentin nuk i është përmbajtur

	kritereve dhe udhëzimeve të tij nuk e miraton, ose i ben vërejtjet për përmirësim. Këtë raport ai ja paraqet komisionin së bashku me punimin e temës së diplomës. (Referuar Rregullores së studimeve të UAMD-së, neni 68); Rregullores së Fakultetit të Biznesit neni 38, 59; Rregullores së Programit neni 17). Detajet jepen në (Evidencën 12. Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit dhe Evidencat 14. Rregullore e Tezes se Diplomes ne Fakultetin e Biznesit; 14.1. Rregullore e Mikrotezes ne Fakultetin e Biznesit).			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studentët vlerësohen me notë për mbrojtjen e diplomës dhe kjo pasqyrohet në procesverbalet e depozituara në sekretarinë mësimore. (Evidenca 13. Rregullore e Provimeve ne Fakultetin e Biznesit dhe neni 17 i Rregullores së Programit).			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të këtij programi studimi studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës. Këto janë percaktuar dhe miratuar nga MASR. (Suplementi i diplomes, MP Drejtimi i SME-ve).			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Kopja e plote e programit te zhvilluar te studimeve u jepet studenteve me depozitimim e nje kerkese.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	GVJ konstatoi nga vizita në institucion se dokumentacioni për studentët ne vite është i plote por ka student të vitit të kaluar ende të pa matrikuluar. Sekretaria na vuri në dispozicion kërkesën që ka bërë per matrikulimin e studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e	GVJ konstaton se referuar përgjigjeve dhe evidencave të dhëna nga GVB për të katër kriteret e Standardit IV.1 asnjë prej tyre nuk ka lidhje me kriteret sipas manualit të vlerësimit. Vetë raporti i GVB-së i dorëzuar nga IAL në ASCAL ka të tjera kritere të vendosura në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>vend të këtyre kritereve që duhet të kishte.</p> <p>Nga verifikimi i kryer nga GVJ për secilin anëtar të personelit akademik që është i përfshirë në këtë program studimi, gjatë vizitës në zyrën e BNJ u evidentua mbajtja e dosjeve të tyre me të gjitha dokumentet kryesore. Ndërsa vetëm për 2 dosje PAE që nuk gjendeshin në zyrën e BNJ u kërkuan prej tyre të dërgoheshin përmes sistemit të ASCAL, dhe IAL i vendosi ato në sistem.</p> <p>Nga verifikimi i dosjeve të PAE-ve dhe evidencave për ngarkesën mësimore në këtë program mësimor dhe gradën përkatëse të çdo PAE rezultuan mospërputhje në grada dhe se në këtë program ishin angazhuar në mësimdhënie PAE pa gradë shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek procedurat e posaçme për rekrutimet e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e Rregullores së IAL-së. Në bashkëpunim me departamentin, kjo drejtori kujdeset për plotësimin e nevojave për PAE dhe PAK.</p> <p>Edhe nga vizita e realizuar në zyrën e BNJ dolën në pah detyrat që kryen në lidhje me këtë proces. Kjo procedure konsiston në koordinimin e punës me njësinë bazë për programin MP “Drejtimit i SME-ve”.</p> <p>GVJ gjatë diskutimit me drejtuesit e IAL-së u bë me dije se është njësinë bazë ajo e cila në fillim të vitit akademik përcakton dhe paraqet pranë Dekanatit nevojat për staf shtesë PAE ose PAK dhe kriteret që duhet të plotësojë. Dekanati i përcjell pranë Rektoratit i cili e përcjell kërkesën tek Drejtoria e Burimeve Njerëzore (DBNJ) e cila harton oferta e punës duke përfshirë këtu kriteret e pranimit, të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara nga njësinë bazë. Këto kërkesa shpalljen në njoftimin për vend pune vakant në ëeb si dhe në buletin e APP-së. Pas marrjes së aplikimeve krijohet komisioni at-hoc i ngritur nga Dekanati me përfaqësues të njësisë bazë dhe me një përfaqësues nga Rektorati për vlerësimin e dosjeve dhe zhvillimin e intervistave për kandidatët.</p> <p>GVJ kërkoi të depozitoheshin në ASCAL praktikat e rekrutimeve të PAE të kryera gjatë 3 viteve të fundit me qëllim evidentimin e procedurave dhe hapave të ndjekur. Nga IAL u depozitua vetëm një praktikë e cila nuk përkon me PAE të angazhuar në këtë program dhe si rrjedhim nuk mund të merret për referencë, ndërkohë që munguan të depozitohen praktika të tjera.</p> <p>GVJ konstaton mungesë transparence në RVB për mos kthim përgjigje sipas kritereve të kërkuara në manualin e vlerësimit, si edhe stafi që angazhohet në mësimdhënie në ciklin e dytë duhet të ketë status të qartë në të gjitha evidencat dhe të mos shfaqet ndryshe</p>





	në evidenca të ndryshme që do të thotë se në këtë program duhet të angazhohen vetëm staf akademik me grada shkencore.			
<b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	<p>Nga vizita dhe diskutimet në IAL, GVJ evidenton se Drejtoria e Burimeve Njerëzore koordinon procesin e cituar edhe më sipër. Por është njësia bazë ajo e cila në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe Rektoratin e ushtrojnë veprimtarinë e rekrutimit të PAE dhe PAK.</p> <p>GVJ kërkoi minutat e mbledhjeve të DM ku është diskutuar dhe analizuar ngarkesa mësimore, kërkesa për PAE dhe PAK shtesë, si edhe përcaktimi i kritereve për rekrutim të tyre.</p> <p>Referuar evidencave të dërguara nga IAL, përsëri GVJ evidenton se nuk rezulton që DM të ketë kryer mbledhje ku të ketë diskutuar, analizuar dhe përcaktuar kërkesat dhe kriteret ashtu siç kërkohen nga kriteret dhe standardet përkatëse.</p>			
<b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ i sygjeron IAL-së të ketë në Rregulloren e Rekrutimit të pasqyruara kriteret e përgjithshme për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor. Këto kritere të përfshijnë notën mesatare të ciklit të parë dhe notën mesatare të ciklit të dytë të studimeve, profilin e studimit, shkollim dhe kualifikim të mëtejshëm, përvojën e punës në mësimdhënie, kualifikime brenda apo jashtë vendit, njohuri të gjuhëve të huaja, aktiviteti botues shkencor, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>GVJ konstaton se referuar përgjigjeve të dhëna në RVB për të katër kriteret e Standardit IV.2 nuk gjen asnjë përgjigje për kriteret por veç jepen referenca dhe citohen evidenca. Megjithatë GVJ gjatë vizitës në IAL evidentoi se, UAMD ka krijuar mjedise dhe mundësi shumë të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit të Programit “Drejtimi i SME-ve”.</p> <p>Gjatë vizitës në IALm GVJ u informua dhe pa kushtet shumë të mira për zhvillimin e detyrave të personelit akademik. Zyrat ishin të pajisura me mjete dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e detyrave përkatëse të personelit akademik. Gjithashtu, ambjentet ku zhvillohet mësimi, si auditore dhe klasa, janë të reja por ende kanë mangësi të</p>

	<p>mos plotësimi me videoprojektor për të zhvilluar procesin e mësimdhënies në mënyrë sa më cilësore. Mungesa e sitemit ëireless në mjediset e FB nuk ndihmon në rritjen e cilësisë së procesit të mësidhënies dhe mësim nxënies.</p> <p>Evidentohet cilësisht funksioni i zyrave të sekretarisë të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kontaktit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Në strategjitë e zhvillimit të njësive të UAMD ndër të tjera me prioritet evidentohet kërkimi shkencor i PAE. Kërkimi shihet si pjesë integrale e rolit akademik dhe një faktor kyç në promovim. UAMD i ka dhënë përgjegjësi dhe kërkon prej njësisë bazë identifikimin e fushave të qendrueshme të kërkimit si dhe në bashkërendimin e përfshirjen e elementeve të planifikimit të veprimtarisë shkencore. UAMD përmes Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve mbështet aktivitetin kërkimor dhe shkencor përmes aplikimit në projekte dhe nxitjes së personelin akademik për zhvillim profesional të vazhdueshëm.</p> <p>Personeli akademik i DM ka treguar disa arritje në fushën e kërkimit. Ky fakt mbështetet në numrin e kënaqshëm të artikujve të botuar si edhe pjesëmarrja në konferenca të organizuar brenda dhe jashtë vendit. Kualifikimi i personelit akademik në fushën e kërkimit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Personeli akademik i këtij programi studimi është i kualifikuar dhe i aftë në përdorimin e teknologjive të reja dhe metodave inovative në funksion të mësimdhënies sa më cilësore.</p> <p>Personeli akademik i FB ka qënë pjesë e mobiliteteve Erasmus+ me karakter trajnues për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies. Në objektivat dhe rezultatet e këtyre mobiliteteve janë qartësisht të motivuara qëllimet e vizitave dhe pritshmëritë e tyre.</p> <p>Sipas komunikimit dhe verifikimit të kryer gjatë vizitës në IAL, na u bë me dije se institucioni shumë shpejt do të krijojë edhe mbështetjen me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimi (si, videoprojektorët, disponibiliteti i shërbimit të internetit etj.) të cilët nuk ishin ende në funksionim.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Stafi i FB kujdeset që të respektojë planet, objektivat dhe rezultatet e paracaktuara të programit të studimit. Planet mësimore, syllabusi, orari i mësimi dhe dokumenta të tjera që personeli akademik depoziton në departament (si regjistri i pedagogut, rezultatet e vlerësimit të studentëve gjatë semestrit, etj.) dëshmojnë për kujdesin e tyre në respektim të këtyre elementeve.</p> <p>Gjithashtu, nga personeli akademik në vazhdimësi është krijuar një komunikim pozitiv me studentët për tju gjendur atyre pranë me</p>

	qëllim arrijen e objektivave të tyre në drejtim të përgatitjes në këtë program mësimor. Ky fakt u mbështetet edhe nga përgjigjet e marra nga studentët gjatë vizitës në IAL.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstaton se referuar përgjigjeve të dhëna në RVB për të katër kriteret e Standardit IV.3 nuk gjen asnjë përgjigje për kriteret por veç jepen referenca dhe citohen evidenca.  Megjithatë GVJ gjatë vizitës në IAL evidentoi se procesi mësimor për Programin “Drejtimi i SME-ve” zhvillohet pranë ambjenteve të UAMD në Spitalllë. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore, Godina A dhe Godina B.			
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Godinat janë të organizuar në disa kate dhe kanë në përbërje të tyre disa salla leksionesh dhe seminaresh, si edhe laboratorë. Këto salla janë produkt i investimit të universitetit.  Ambientet ku zhvillohet mësimi i këtij programi studimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme në përputhje me normativën e përcaktuar në VKM. nr. 418 date 10.05.2017, sipas të cilit kërkohen 2.5 m <sup>2</sup> për një student.			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita e realizuar në ambjentet e Fakultetit konstatuam se mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret e nevojshme për të zhvilluar një proces sa më cilësor të mësimdhënies.  Në këto mjedise gjejmë mjete mësimore të duhura që lejojnë një zhvillim normal të procesit mësimor.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Të gjitha klasat ku zhvillohen orët e seminareve, sallat e leksioneve, sallat e leximit si edhe ambjentet e përbashkëta kanë sistem ngrohje i cili ishte në funksionim edhe gjatë vizitës që kishim në IAL. Kështu është i mundur një realizim sa më cilësor i të gjitha orëve mësimore.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Veçse, mundësimi i sistemit ëireless në mjediset e Fakultetit do të ndihmonte në përmirësimin e procesit mësimor.			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se referuar përgjigjeve të dhëna në RVB për të katër kriteret e Standardit IV.4 nuk gjen asnjë përgjigje për kriteret por veç jepen referenca dhe citohen evidenca.  Megjithatë GVJ gjatë vizitës në IAL evidentoi se Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka dy biblioteka në Spitallë të cilat mund të përdoren nga studentët e FB. Studentët e këtij programi studimi mund të shfrytëzojnë mjediset e të dy bibliotekave si në aksesin e literaturës ashtu dhe në përgatitjen mësimore.  Gjithashtu, studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë bibliotekat edhe në oraret e pasdites dhe ditën e shtunë përgjatë orareve të tyre të studimit.  Studentët mund të aksesojnë edhe informacionin online i cili ofrohet nga burime elektronike me abonim ose falas, nga projekte të ndryshme.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës si rezultat i pjesëmarrjes në projekte që kanë patur në fokus mire menaxhimin e saj ka zhvilluar strategjinë e saj për administrimin dhe pasurimin e fondit të bibliotekës.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Orari i Biblotekës, 8-16, nga e hëna në të dielë. Nr i titujve 2000-2200 tituj. Çdo bibliotekë ka staf dhe universiteti ka 3 biblioteka. Kur është e nevojshme stafi Biblotekës qëndron dhe me orar te zgjatur me rotacion deri në orën 20:00. Bibloteka ka 70 poste leximi dhe biblioteka promovohet tek studentët e rinj gjithmonë gjatë javës së prezantimit në fillim të vitit akademik.  Në Bibliotekën e FB, studentët e këtij programi studimi gjejnë tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve që ndjekin dhe literaturën ndihmëse të nevojshme, por jo të gjithë titujt që kanë detyrim në syllabulls në fuqi.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Fondi i bibliotekës ka pasë disa shtesa titujsh në vitet e fundit (në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj) duke synuar të reflektojë azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës. Në përditësimin e fondit merren në konsideratë vazhdimisht edhe sugjerimet e studentëve në mënyrë që të sigurohet literaturë sa më e përshtatshme.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	

	<p>Konkretisht, Bibloteka ka marre ka 4 botime për vitin 2017, dhe 10 botime për vitin 2016. Studentet dhe stafi kane akses ne ebsco dhe bibloteka te tjera online. UAMD ka akses edhe ne biboteka te nje universiteti Zvicerian.</p> <p>Gjatë vizitës në ambjentet e Bibliotekës së FB u vu re se biblioteka ofron hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët. Salla e studimit kishte komoditet shumë të mire dhe vende të mjaftueshme për një ditë normale shkolle, si edhe kishte kompjutera nga ku studentët mund të aksesnin librarinë elektronike dhe të kryenin punë kërkimore individualisht apo në grup. Kapaciteti i stafit të bibliotekës ishte i tillë që me pak sforcim prej tyre mund të përballonin nevojat e studentëve për shërbim, apo edhe shfrytëzim të mjediseve për punë në grup apo prezantime. Stafi i bibliotekës ishte prej shumë vitesh në detyrë dhe zotëronte njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit dhe gjuhëve të huaja, si dhe zotëron aftësi për të ofruar shërbime përkatëse. Orari i shfrytëzimit të bibliotekës është i përshtatshëm për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimit, i cili është plotësisht i mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të studentëve të këtij program.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>GVJ konstaton se referuar përgjigjeve të dhëna në RVB për të katër kriteret e Standardit IV.5 nuk gjen asnjë përgjigje për kriteret por veç jepen referenca dhe citohen evidenca.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në IAL u bë me dije se UAMD për studentët e këtij programi nuk ka sistem për menaxhimin e informacionit por ka një data bazë për ruajtjen e informacionit që regjistrohet dhe mbahet në hard copy; dhe ruajtjen e informacionit që regjistrohet në formë elektronike.</p> <p>Kryesekretaria e FB kryen veprimtaritë në vijim: Regjistrimi i studentëve dhe mbajtja e bazës së të dhënave dhe rezultatet e tyre, në formë shkresore dhe elektronike; Plotësimi i të gjithë dokumenteve individuale çertifikuës mbi rezultatet e pjeshme ose të plota të sudimeve; Mbajtja e dokumentacionit mbi procesin mësimor dhe ndjekja e ecurisë së procesit mësimor. Mbahet informacion lidhur me studimet (planet mësimore, strukturat e vitit akademik etj.) për</p>



	<p>programin e MP “Drejtimi i SME-ve”.</p> <p>Kryesekretaria e FB menaxhon edhe dokumentacionin themelor për studentët në përputhje me ligjin në fuqi. Nga vizita e realizuar në ambjentet e saj patëm mundësi të vëzhgonim nga afër këtë dokumentacion: Regjistri themeltar pasqyron rregjistrimin e studentit duke u identifikuar me numër unik matrikullimi, i cili i shërben studentit deri në momentin e marrjes së diplomës. Në lidhje me programin MP “Drejtimi i SME-ve”, për studentet e pa matrikuluar i është bërë kërkesa QSHA-së, nga programi MP “Drejtimi i SME-ve” para vitit 2018-19, rezulton një studente pa matrikul kurse per vitin 2018-2019, 4 studente. Te dhenat per vitin 2019-2020 nuk jane hedhur akoma ne rregjister.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Informacioni mbi PAE dhe atë ndihmës menaxhohet dhe ruhet nga njësitë dhe zyrat përkatëse në UAMD, të tilla si Drejtoria e Burimeve Njerëzore, dhe ajo e Financës, si në formë elektronike ashtu edhe në hard copy. Dosjet e tyre kanë informacionin që ruhet për PAE, PAK dhe atë ndihmës, të tilla si CV-të.</p> <p>Ndërsa pranë DM dhe FB ruhen planet mësimore, syllabuset, ngarkesa akademike, etj. Këto dokumente ruhen në departament dhe bëhen pjesë integrale e analizës mësimore dhe shkencore të departamentit. Analiza mësimore dhe shkencore duke qënë se përcillet në Fakultet dhe Rektorat, bëhet pjesë e të dhënave të përgjithshme të institucionit.</p> <p>Dokumentacioni për pedagogët e ftuar të programit ruhet në departament, fakultet, në zyrën e personelit dhe pagave si dhe në zyrën e financës.</p> <p>Veprimtaria e personelit akademik të këtij programi studimi gjenden të publikuar vetëm në curriculum vitae të stafit akademik në website të UAMD-së dhe në websites të organizatorëve të eventeve shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se përgjigjet e dhëna nga GVB për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit nuk lidhen me kriteret e përcaktuara në manualin e vlerësimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përmes diskutimit gjatë vizitës në IAL, prej të intervistuarve u evidentua se institucioni nuk disponon sistem të menaxhimit të informacionit nëpërmjet të cilit të mund të administrohen të gjithë informacionet që lidhen me stafin dhe studentët, aktivitetin e tyre dhe platformë interactive komunikimi për programin e studimit MP “Drejtimi i SME-ve”. Përmes këtij sistemi studenti duhet të merrte në</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet</p>	<p>kohë reale informacion në lidhje me të dhënat e regjistrimeve, lëndët, për të drejtën për të hyrë ose jo në provim, prenotimin e provimit, grafikun e provimeve online, vlerësimin e bërë nga pedagogu gjatë</p>

drejtuese dhe titullarët.	semestrit, vlerësimin në provim dhe notën përfundimtare notat, etj.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	<p>Sipas komunikimit me drejtues të IAL-së gjatë vizitës GVJ u informua se UAMD disponon një sistem të menaxhimit të informacionit dhe platformë interaktive komunikimi për studentët e ciklit të parë të studimit. Këtë sistem do ta testojnë për ta implementuar edhe për ciklin e dytë të studimeve. Gjithashtu, informacione që lidhen me aktivitete të ndryshme, publikohen në website të UAMD-së dhe në rrjetet e saj sociale. Në lidhje me funksionimin e faqes së internetit gjatë takimit në IAL u testua website i UAMD për një njoftim për vende pune në UAMD dhe u evidentua që në versionin celular ky link nuk hapej.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL konstatuam përgjegjësi i departamentit, ose struktura të tjera të dekanati dhe NJSBC ende bëjnë monitorimin fizik të informacionit mbi veprimtarinë mësimore të personelit të këtij programi studimi përderisa nuk kanë ende një sistem menaxhimi informacioni të instaluar në UAMD.</p> <p>GVJ evidenton se UAMD duhet të implementoj Sistemin e menaxhimit të informacionit edhe për stafin dhe studentët e programit të studimit MP “Drejtimi i SME-ve” pasi ai siguron akses në informacione dhe dokumenta si për stafin e UAMD-së edhe për studentët e këtij programi studimi. Përmes implementimit të MIS për të gjithë do të sigurohet edhe adresimi i disa prej kërkesave dhe kriterëve të kërkuara për UAMD-në.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		<b>X</b>		

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se referuar përgjigjeve të dhëna në RVB për të katër kriteret e Standardit IV.5 nuk gjen asnjë përgjigje për kriteret por veç jepen referenca dhe citohen evidenca.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line	<p>Gjithashtu GVJ evidenton se GVB shprehet se Institucioni dhe njësi bazë që ofron programin harton raporte financiare dhe për këtë evidentojnë edhe referencat 562, 563, 564, 565, 566, 567 në RVB.</p> <p>Vetëm citimi i këtyre evidencave nuk mbështesin plotësimin e këtyre kriterëve pasi ato kërkojnë përshkrim dhe analizë të evidencave për plane financimi për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>detyrimet financiare, grantet vendëse apo huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zë të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>studimi (për ciklin e parë të studimit Bachelor, për ciklin e dytë të studimeve, MP dhe MSh, si edhe për ciklin e tretë të studimit).</p> <p>Nga shqyrtimi i (<i>Evidencës 113. Tabele me të dhënat financiare mbi koston e Programit SME</i>) , depozituar nga IAL në sistemin e ASCAL, rezulton se kostoja vjetore për çdo kredit për studentët në programin e MP “Drejtimi i SME-ve” për vitin 2018-2019 rezulton 1’352 lekë dhe ka pësuar një rritje krahasuar me vitin akademik 2016-2017 e cila rezulton 1’219 lekë, ndërsa kostoja vjetore për 60 kreditet për vitin 2016-2017 është 73’111 lekë dhe për vitin 2018-2019 është rritur me rreth 11% duke shkuar në 81’107 lekë.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>GVB bazuar në referencat 565, 566 dhe 567 në RVB-në e saj (të gjitha këto janë e njëjta evidencë por GVB e citon disa herë me numra të ndryshëm) shprehet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• UAMD kryen auditime periodike të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar, në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi;</li> <li>• UAMD dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndryshime në financim nëse është e nevojshme;</li> <li>• UAMD ka dëshmuar se ka pasë qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe përmirësimit të situatës financiare të tij</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Referuar përgjigjeve të GVB-së, GVJ evidenton se ato nuk përgjigjen për plotësimin e këtyre kriterëve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Evidencat lidhur me auditimin e IAL-së i janë kërkuar nga GVJ që në nisjen e procesit të vlerësimit të jashtëm që ata ti depozitonin në sistemin e ASCAL pasi aty rezultonte se ishte depozituar një evidencë e tillë e cila nuk ishte raporti i auditimit që prezanton gjithë elementët e kërkuar në këto kriterë. IAL nuk e ka depozituar ende edhe pasi ju rikërkuar për ta depozituar në sistemin e ASCAL.</p> <p>Në përfundim GVJ konkludon se ka mungesë përgjigjesh dhe evidencash të domosdoshme nga IAL për kryerjen e një vlerësimi sa më të saktë, por bazuar në njohuritë se IAL është subjekt i kontrollit të KLSH-së (pavarsisht se edhe kjo evidence nuk na u vendos në dispozicion) po e konsiderojmë të përmbushur pjesërisht me tendencën për lart.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Rregullorja e institucionit, rregullorja e Fakultetit të Biznesit, rregullorja e Departamentit të Menaxhimit dhe Rregullorja e programit të studimit ( <i>neni 22</i> ) në UAMD janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rregullorja e Fakultetit të Biznesit ( <i>neni 47</i> ), rregullorja e Departamentit të Menaxhimit ( <i>neni 11, pika s</i> ) specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi nga vizita në institucion, shqyrtimi i dokumentacionit dhe sidomos intervistat me studentët e programit, se politikat dhe procedurat që e ndjekura nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. ( <i>Evidencat 6. Rregullore e Re UAMD; 7. Rregullore e Fakultetit të Biznesit; 8. Rregullore e Departamentit të Menaxhimit; 11. Rregullore e Sekretarise Mesimore në Fakultetin e Biznesit</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e UAMD, të Fakultetit të Biznesit, të Departamentit të Menaxhimit dhe të programit të studimit. Në këtë program studimi ka patur edhe largime edhe transferime studentësh. Nga takimi me Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës u konfirmua që institucioni përdorë ditet e karrierës për të bërë publike procedurat dhe kriteret e pranimit. Politikat dhe procedurat bëhen publike përmes faqes së internetit sipas RVB dhe vizitave në institucion. Por nga një verifikim, nuk kishte asnjë informacion në këtë faqe.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ( <i>Evidenca 47. Memo për Kriteret e Pranimit të Studenteve dhe 110. Njoftime për studentet</i> ), konfirmojnë që UAMD miraton në fillim të vitit akademik kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret përkatëse.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme	Përpara çdo fillimi viti akademik, sipas informacionit që GVJ mbledhi gjatë vizitës në institucion, UAMD njihet palët e interesuara me programin e studimit që ofron dhe kërkesat e përgjithshme dhe të

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

e të veçanta të programit të studimit	vecanta për cdo program. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet ditëve të karrierës dhe vizitave në gjimnaze.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e Universitetit, Fakultetit të Biznesit, Departamentit të Menaxhimit dhe Rregulloren e programit të studimit. Nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, rregulloret u vihen në dispozicion studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet që kanë studentët me përgjegjës të departamentit i cili shërben edhe si koordinator i programit. Neni 56 i rregullores së re UAMD përcakton kriteret e transferimit të studimeve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregullorja e programit të studimit MP në “Drejtimi i SME-ve” (Kreu V, neni 22), Neni 56 i rregullores së re të UAMD, përcaktojnë procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të UAMD në shkolla të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni ad-hock i Ekuivalentimit. Studentëve u vihet në dispozicion rregullorja, nëpërmjet të cilës ata njihen me kriteret e transferimeve.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në programet e cdo lënde. Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimit, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në cdo lëndë.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Departamentit të Menaxhimit, dhe të programit përkatës të studimit. Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me përgjegjës të departamentit (njëkohësisht edhe koordinator i programit) dhe pedagogët udhëheqës të tyre.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Këto takime të hapura janë zhvilluar edhe në shkolla të mesme. Gjithashtu UAMD është shumë aktiv në rrjetet sociale, përgatit fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





	studimit të ofruara prej tij.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e universitetit si edhe një informacion i përgjithshëm shfaqen në faqen e internetit të UAMD, ku kurrikula ngelet për tu përditësuar.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës. Një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambjentet e institucionit. Sipas intervistave në institucion dhe RVB-së, në web-faqen e UAMD publikohen planet mësimore, por nga verifikimi i kryer, informacioni që ofrohet në faqen e internetit është shumë i pakët dhe kurrikula nuk i përket këtij programi studimi.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione publike dhe biznese.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e Fakultetit të Biznesit, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e universitetit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	UAMD punon fort me komunikimin online në rrjetet sociale për të mbajtur studentët e informuar mbi programet e studimit dhe aktivitetet në universitet. Gjithashtu, gjatë intervistës me stafin akademik por edhe grupin e punës na u referua se çdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



standardit				<b>X</b>
------------	--	--	--	----------

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Për programin e studimit sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Biznesit në UAMD.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Sekretaria mësimore, nëpërmjet rregjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për cdo vit akademik.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar në vitin 2016-2017 ishte 17, prej të cilëve nuk u diplomua asnjë student. Nota mesatare në hyrje 6,82 dhe nota mesatare në dalje 6,53.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ka ardhur në rënie dhe në vitin 2018-2019 rezultojnë 13 studentë të regjistruar, dhe 2 studentë inaktiv. Vihet re edhe një rnie e notës mesatare nga 7,13 në 5,65. (sipas Evidences 68). Këto shifra përforcojnë sugjerimin e GVJ për të shikuar mundësinë e bashkimit të dy masterave profesional që ofron departamenti.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ mësoi se studentet që duan ta frekuentojnë një lëndë pas riorganizimit të programit, bëjnë një kërkesë në Dekanat dhe më pas meret një vendim nga Dekanati.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre.
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ mësoi se ka një liste që mbahet në momentin që pedagogu terheq regjistrin. Po ashtu UMAD përdor një database elektronike excel me të dhënat e studentëve. Studentet që nuk e frekuentojnë i shenohet 0 pikë dhe jo mungese në procesverbalet e provimeve.</p> <p>Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë mësimore.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të	Në fund të cdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve. Për diplomimet në vitet e mëparshme disponohen të dhëna të plota sipër notat mesatare në hyrje dhe dalje si dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



përmirësimit të këtyre treguesve	punësimin e tyre. Vihet re një rënie e notës mesatare në hyrje dhe në dalje nga 7,13 në 5,65 për vitin 2018-2019 , nderkohe qe ne vitet e meparshme ka qene konstante (sipas Evidences 68).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi V.5**  
**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nëpërmjet Statutit të UAMD (neni 88-90) institucioni parashikon angazhimin dhe vendimmarrjen e studentëve në aktivitete kërkimore dhe kulturore, ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të FB (neni 84, pika b).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentet e vëna në dispozicion, GVJ konfirmoi se studentët ishin të përfshirë në vlerësimin mbi procesin akademik (pjesë e GVB), por nga biseda me grupin e studentëve u kuptua qe ata këshillohen me stafin akademik dhe shefin e departamentit por nuk përdorin zyrtar mbështetëse për këtë qëllim. Sipas Statutit ata kanë formuar edhe Këshillin studentor. Studentët kishin përfaqësuesin e tyre si në këshillin e etikës (neni 22 i Statutit të Ri UAMD) por nuk ka përfaqësues të studentëve në zyrën e NJBSC.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	GVJ konstatoi se programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve. Statuti i UAMD dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedurë joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendim marrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtëpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetsori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri. (Evidenca 84. Analiza pyetesoreve nga studentet, staf akademik, staf administrativ).
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/	Statuti i UAMD (neni 89), Rregullorja e Fakultetit (neni 59 dhe 62), dhe Rregullorja e programit të studimit MP në “Drejtimi i SME-ve” (neni 37 pika c dhe f) mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



njesisë/pedagogut përgjegjës.	ndiqen nga institucioni në këtë rast.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Zyra e Komunikimit, Alumni dhe Karrierës në UAMD kryen disa funksione, përfshirë edhe atë të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve. kjo zyrë është e re por shumë active në komunikimin përmes rrjeteve sociale. Gjate vizitës GVJ konstatoi se studentët nuk kanë shumë dijeni dhe nuk e shfrytëzojnë këtë zyrë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimarrëse ( <i>Statuti i Ri UAMD, neni 89</i> ), këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies, studentët kanë mundësi që të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Të drejtat e studentëve në këtë drejtim, duhet të përcaktohen edhe në Rregulloren e Zyrës së Komunikimit, Alumni dhe Karrierës në UAMD.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<i>Evidenca 86. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës si edhe Evidenca 89. Draft i Strategjisë së Komunikimit – UAMD</i> , përcaktojnë qëllimin dhe aspektet e komunikimit në UAMD për ti shërbeyer nevojave për zhvillim të karrierës së studentëve, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbime të ndryshme nëpërmjet këshillimit, konsultimeve dhe partneriteteve të qëndrueshme, që nga organizimi i përvitshëm i prezantimit të programeve të studimeve në ambjentet e Fakulteteve, informin e studentëve, lidhur me mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, dhe mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Sipas <i>Evidencës 86. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës</i> , një nga detyrat e kësaj zyrë është edhe perpilimi, plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të Punësimit për Studentët e diplomuar. Nga vizita në institucion, GVJ iu konfirmua se kjo zyrë publikoh herë pas here njoftime për mundësi punësimi, duke ia dërguar edhe grupeve të studntëve të diplomuar sipas profileve të tyre të studimit.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UAMD ka ngritur struktura të tilla si NJSBC Qëndrore e cila quhet “Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë”, që nga muaji Maj 2019, dhe NJSBC pranë çdo Fakulteti të cilat kanë hartuar procedura për të siguruar cilësinë e programeve ( <i>neni 81 i rregullores së re në UAMD</i> ). Gjatë vizitave në institucion GVJ iu referua që kjo Njesi ka 8 anëtarë në përbrjën e saj por në takim u paraqit vetëm kryetari i saj. GVJ konstatoi pas diskutimeve, se kjo njësi e ka të vështirë të monitorojë të gjitha programet e ofruara nga UAMD. Për këtë arsye dhe si pasojë e nevojave imediate të institucionit për akreditimin e disa programeve studimore njëkohësisht, është ngritur NJSBC pranë Fakulteteve përkatëse ku anëtarë janë shefat e çdo departamenti dhe 2 zv/dekanet. Kjo strukturë e dytë mund ti shërbejë si ndihmë njësisë kryesore por, mendojmë që krijon konflikt interesi në vetvete si edhe mbi-vendosje detyrash për përgjegjësat e departamenteve. ( <i>Referuar. Kreu VII i Statutit të ri</i> ) Në përfundim, GVJ mendon se NJSBC pranë UAMD nuk funksionon plotësisht.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UMAD ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme ( <i>Referuar. neneve 68-69 të Rregullores së Vjetër</i> ), të tilla si: rishikimi i kurrikulave ku sipas vizitave në institucion janë bërë disa takime me biznese, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të pedagogëve ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentet. Sistemi operativ i sigurimit të cilësisë përshkruhet në rregulloren përkatëse ( <i>Kreu VI mbi Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin, i Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve</i> ). Kjo rregullore përshkruan elementët e syllabusit dhe pyetësorin e studentëve, por nuk detajon procedurat, udhëzimet dhe format e përdorimit dhe standartet për sigurimin e cilësisë në institucion dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





	<p>programin e studimit.</p> <p>Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë pranë secilit Fakultet. Në këtë Njësi përfshihen personel i brendshëm i Universitetit; por nuk ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, çka e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, siç e pasqyron organigrama.</p> <p>Sugjerohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të detajohet manuali i sigurimit të cilësisë</li> <li>- Të këtë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UAMD bën përpjekje të vazhdueshme në kuadër të SBC-së, siç u përmend edhe më lart. Gjatë vizitave në institucion na u përmendën përpjekjet që stafi akademik ka bërë për të krahasuar kurrikulën ekzistuese dhe përmirësimin e saj me kurrikula të programeve të ngjajshme në vendet e BE-së.</p> <p>Institucioni ka kaluar me sukses vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional dhe është në process për akreditimin e disa programeve të studimit.</p> <p>UAMD nuk pasqyron në raportin vjetor të cilësisë masat e ndërmara në lidhje me raportet e ekspertëve të jashtëm dhe rekomandimet e tyre. Ajo që nevojitet të shënohet është fakti i angazhimit i po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra.</p> <p>Në raportin vjetor të NJSBC nuk ka një analizë në lidhje me instrumentat e sigurimit të cilësisë të përdorura gjatë vitit akademik, si psh rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e profesorëve, konkluzionet e nxjerra dhe plan aksioni për t'i vendosur në funksion.</p> <p>Sugjerohet pavarësia e stafit në hallkat e sigurimit të cilësisë, rishikimi i instrumentave për të garantuar përdorshmërinë e tyre dhe përfshirja e përdorimit të instrumentave në analizen vjetore të NJSBC.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjstëve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Gjatë vizitave në institucion vumë re që të gjithë aktorët e brendshëm, duke filluar nga dekani i fakultetit deri tek studentët, përqipen të japin kontributin e tyre në kuadër të SBC-së gjë e cila tregon për formimin e një kulture institucionale të orientuar drejt cilësisë. UAMD ndjek procedura periodike si rishikimi i syllabuse apo kurrikula e programeve e rishikuar, kjo edhe në kuadër të përmushjes së detyrimit ligjor për përshtatjen me ligjin e ri të arsimit, por edhe si pasojë e politikës institucionale (<i>Referuar, Kreu VII i Statutit të ri, neni 68-69 i Regullores së Vjetër; Evidenca 19. Analize Vjetore për Programin e Studimit Master Profesional Menaxhim Biznesi; 35. Analiza vjetore e Departamentit të Menaxhimit dhe 36. Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Biznesit</i>).</p> <p>Përveç përdorimit të mekanizmave të mësipërme, sigurimi i cilësisë</p>

	<p>shtrihet edhe ne rekrutimin e stafit, organizimin e programit mësimor, zhvillimin e programit dhe kërkimin. NJSBC në cdo rast është prezent për të siguruar cilësinë dhe për të krijuar një kulturë në rang institucional.</p> <p>Ajo që nevojitet të shënohet është fakti në angazhimit e po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra.</p> <p>Sugjerohet pavarësia e stafit në hallkat e sigurimit të cilësisë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Njësia bazë për menaxhimin e programit të studimit është Departamenti ( <i>Evidenca Nr. 8 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i> ). Kjo njësi bazë së bashku me NJSBC e ngritur pranë Fakultetit të Biznesit ( <i>Evidenca nr. 7 Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> ), kryen mbikëqyrjen, rishikimin dhe monitorimin e programeve. Siç përmendet edhe tek Raporti vjetor NJSBC, kjo Njësi ka si qellim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes ushtrimit të funksioneve të saj. Ndërkohë mbetet për tu konsoliduar NJSBC e ngritur pranë Fakultetit të Biznesit e cila është ende në hapat e para të organizimit të saj, nëse kjo njësi do të vazhdojë funksionin e saj edhe përtej procesit të akreditimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Fakulteti i Biznesit me Departamentet përbërëse si dhe në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë krijojnë komisione adhoc për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtem: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Anketimi i studentëve me anë të një pyetësori</li> <li>2. Mbledhjet departamentale por edhe në rang fakulteti</li> <li>3. Vlerësimi i pedagogut në orën mësimore.</li> </ol> Përdorimi i mekanizmave është relativisht i ri, prandaj ngelet për t'u vlerësuar efikasiteti i mirëfunksionimit të tyre.
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Për sa i përket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitorues, edhe pse janë përmendur në Raportin vjetor të NJSBC, nuk ka një analizë të mirëfilltë të tyre për të kuptuar çfarë është vlerësuar dhe si ka qënë ecuria e vlerësimit, nëse janë marë masa apo ka ndonjë plan aksioni për to. Në fakt ato analizohen dhe përfshihen në Reportet

	vjetor të Departamentit. Sugjerohet që rezultatet e mekanizmave të vlerësimit dhe të sigurimit të përfshihen në një proces vetëvlerësimi të stafit akademik. Po ashtu të integrohen raportet vjetore departamentale në atë të NJSBC-së.			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Në raportet vjetore të Departamentit dhe në raportin e NJSBC duhet të përfshihet një analizë e detajuar e matësve sasior dhe të adresohen mangësitë e ndryshme për përbushje.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Departamenti i Menaxhimit i cili është përgjegjës për programin e studimit nën shqyrtim, bën vlerësime periodike të brendshme për programin e studimit dhe i pasqyron në raportin vjetor të analizës mësimore në nivel departamenti. Gjithashtu, departamenti realizon në mënyrë periodike analizë të punës mësimore, ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik dhe personelit ndihmës në departament, por edhe në nivelet tjera më të larta në qoftëse është e nevojshme ( <i>Evidenca nr. 19, 30, 35 dhe 36</i> ). Ky vit është viti i parë i akreditimit të programit të studimit dhe UAMD ka përfshirë keto analiza për vetëvlerësim të brendshëm dhe vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Komisioni i Sigurimit të Cilësisë në UAMD ka një mandat 2 vjeçar ( <i>refereuar vizitave në institucion</i> ) dhe në përbërjen e tij ka një anëtar nga çdo Fakultet për të mundësuar përputhshmërinë me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit object vlerësimi.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si	Fakulteti i Biznesit ( <i>Evidenca nr. 30 dhe 36</i> ) dhe Departamenti i Menaxhimit ( <i>Evidenca 35</i> ), për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta si sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurikulës, të mësuarit; intervista të drejtpërdrejta; dëgjime në auditor; testime paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.  Në UAMD përveç NJSBC, departamentit të menaxhimit si njësi bazë e

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>ofrimit të programit të studimit, angazhohen edhe zyrat e tjera të institucionit, si ajo e Projekteve dhe Marredhenieve me Jashtë dhe zyra e Keshillimit të Karrieres, (<i>Referuar informacionit të marre gjatë vizitave në institucion</i>).</p> <p>Rekomandohet të integrohen gjetjet e zyrave mbështetëse në raportet dhe analizat vjetore departamentale dhe të fakultetit për të garantuar procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore dhe objektivat e programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Si pjesë e rëndësishme e filozofisë së UAMB por edhe në Manualin e Cilësisë, shprehet që studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet përfaqësuesve janë pjesë e Senatit, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të UAMD këshillave studentore, Komisionit të Etikes, etj, por në praktikë, u vu re se nuk ka përfaqësues të studenteve të cilët të jenë pjesë e sigurimit të cilësisë së programit. (<i>Evidenca nr.70 dhe Kreu VI mbi Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin, i Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve</i>).</p> <p>Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<p><b>X</b></p>		

<p><b>Standardi VI.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UAMD harton standardet për sigurimin cilësisë të institucionit në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm (<i>Evidenca nr.70 dhe Kreu VI mbi Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin, i Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve</i>) dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Institucioni ka shpërndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet, rektorat) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj, por personeli mbulon njëkohësisht më shumë se një pozicion administrativ, duke mos garantuar pavarësi në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit..</p> <p>Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për</p>	<p>Rregullorja e NJSBC-se përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe pale të tjera të angazhuara në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. NJSBC prane Fakulteteve përkatëse përbëhet nga përgjegjësat e çdo departamenti dhe 2 zv/dekanët dhe nuk ka asnjë përfaqësues të studentëve dhe as raporti vjetor i NJSBC qëndrore nuk është firmosur prej ndonjë përfaqësuesi studentësh. Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit është njësia baze përgjegjëse për cilësinë e programit. Disa nga anëtarët e departamentit janë pjesë e komisioneve të tilla si Komisionet për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Rregullorja e insitucionit (<i>Evidenca 6 dhe 6.1</i>), Rregullorja e Fakultetit të Biznesit dhe Rregullorja e NJSBC (<i>Evidenca nr.70 dhe Kreu VI mbi Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin, i Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve</i>), parashikojnë angazhimin e anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit në mënyrë të barabartë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga vizitat në institucion shihet e nevojshme të rekomandohet që studentët të informohen dhe përfshihen në implementimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>UAMD ka realizuar takime me biznese dhe ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Por gjatë takimeve në institucion nuk qe e mundur të takoheshin përfaqësues të biznesit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<b>X</b>		

<p><b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Insitucioni zhvillon nje pyetësor me studentet për vlerësimin e moduleve dhe profesorëve në fund të çdo semestri (<i>Evidenca 83</i>). Rezultatet e pyetësorëve i vihen në dispozicion drejtuesve të insitucionit si edhe vetë profesorit. Ato diskutohen në mbledhjet departamentale dhe merren masat e nevojshme në rast problematikash. (<i>Evidenca 84</i>) Por në NJSBC përfshihen personel i brendshëm i Universitetit; nuk ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





	ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, çka e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, sic e pasqyron organigrama. Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC harton një plan vjetor të përvitshëm, ku parashikon të gjitha proceset e kontrollit dhe vlerësimit. Me pas harton raportet me gjetjet përkatëse. Gjithashtu NJSBC informon në mënyrë periodike rektoratin, drejtuesit e fakulteteve, përmes tyre në mënyrë konfidenciale të gjithë stafin akademik rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisë të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Rekomandohet që raporti të shpallet publikisht në web faqen e universitetit.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pas rezultateve të vlerësimit, NJSBC-ja harton një raport i cili përcillet tek njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre, duke dhënë sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë. Propozime e NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit për tu reflektuar në vendimmarrje konkrete.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC harton raporte vjetore të vlerësimit të Brendshëm ku pasqyron rezultatet e vazhdueshme të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të institucionit. Këto raporte dërgohen në MASR. Gjithashtu diskutohen në Rektorat dhe Bordin e Administrimit, u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse të Institucionit me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. ( <i>Evidenca "RVB e NJSBC" e vene ne dispozicion pas takimeve ne institucion</i> )			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	UAMD i kushton rëndësi trajnimit të stafit për përmirësimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësidhënies. UAMD organizon leksione të hapura me studentët, merr mendimin e studentëve, nëpërmjet këshillit studentor, mbi çdo program studimor në tërësi, apo për çdo lëndë e pedagog të veçantë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		<b>X</b>		

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Drejtimi i SME-ve” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. UAMD është angazhuar maksimalisht duke krijuar forma të ndryshme bashkëpunimi në funksion të të gjitha proceseve akademike në institucion.
2. UAMD është orientuar fort drejt mbështetjes ndaj studentëve dhe kjo është e formave të ndryshme që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tyre.
3. Impenjimi dhe angazhimi i drejtuesve të institucionit, dhe zyrat mbështetëse që ato vënë në funksion të universitetit, janë një vlerë e shtuar për programin e studimit.
4. Si në asnjë tjetër IAL publike, UAMD ka krijuar mjedise dhe mundësi shumë të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit të këtij programi mësimor.

**Pika të dobta**

1. Mos kryerja e diskutimeve dhe analizave për ngarkesën në këtë program mësimor ka sjellë si pasojë mos respektim të cilësisë dhe standardeve të përcaktuara që mësimi të kryhet vetëm nga PAE që kanë grada shkencore për jo më pak se 70% të ngarkesës mesimore.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë apo person përgjegjës duhet të jenë të përcaktuara dhe në përpythje me kriteret dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.
3. Syllabuset e lëndëve të këtij programi të depozituara në sistemin e ASCAL nuk plotësonin kërkesat sipas kriterëve dhe standardeve të kërkuara.
4. Vijon trendi rënës në numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi.
5. Mungesa e cilësisë akademike të kandidatëve fitues gjatë procesit të rekrutimit të PAE-ve.
6. Raportet e institucionit dhe të dhënave të përpunuar për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie nuk janë të publikuara duke krijuar mungesë transparence dhe jo të gjithë aktorët janë të informuar.
7. Mos plotësimi i detyrave që ngarkon statuti i UAMD-së në Kreun VII të tij si edhe kuadri rregullator në fuqi nga Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë së Institucionit dhe NJSBC.
8. Mungesë transparence dhe simetrie informacioni në plotësimin e RVB-së.
9. Mungesa e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi.



10. Mungojnë lëndë karakterizuese në kurrikul për ti mundësuar studentëve të thellohet specifikisht në problemet e menaxhimit të SME-ve si dhe për ti ofruar atyre shprehje të veçanta në fushën e drejtimit të SME-ve duke plotësuar dhe nevojat e tregut të punës, në nivel lokal e kombëtar.
11. Mungon një studim i mirëfilltë tregu ku të analizohen nevojat e tregut të punës sot dhe identifikimin e atyre moduleve/lëndëve të reja që do të pasuronin kurrikulen e programit të studimit. Gërshetimi i këtyre nevojave me njohuritë profesionale do të mundesonin përgatitjen e specialistëve që i mungojnë tregut të punës sot. Kjo gjë do t'i jepte një avantazh konkurrues edhe vetë insitucionit në të ardhmen.
12. Mungon një plan-buxhet i detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond i vecante për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line.
13. Mungon përfshirja e stafit të pavarur dhe perfaqesuesit të studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.
14. Mungon një analizë e të dhënave të punësimit të studentëve pas diplomimit.
15. Logjistika IT dhe programet kompjuterike, e varfër dhe me mungesa.

## Rekomandime

1. GVJ konkludon se në IAL nuk kryhen diskutime dhe analiza për ngarkesën në këtë program mësimor duke sjellë si pasojë mos respektim të cilësisë dhe standardeve të përcaktuara që mësimi të kryhet vetëm nga PAE që kanë grada shkencore për jo më pak se 70% të ngarkesës mesimore, si edhe për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie nevojitet zbatimi i Udhëzimit Nr.29, datë 12.09.2018 të MASR, pasi evidentohet se pothuajse të gjithë PAE-të kanë marrë orët suplementare prej 200 orë mësimore në auditor, përveçse orëve të tjera të punës për angazhime të tjera në IAL. Gjithashtu, për vitin akademik 2018-2019 për këtë program studimi, GVJ evidenton se kategoria e PAE me grada shkencore japin vetëm 47.2% të orëve mësimore; ndërsa PAE që nuk kanë një gradë më të lartë sesa cikli i studimit ku japin mësim, mbulojnë 39.3% të orëve mësimore. GVJ konkludon se IAL nuk është në përputhje me Ligjin 80/2015 - Neni 59, pika 6, ku kërkohet që PAE me grada shkencore të japin jo më pak se 70% të orëve mësimore në Programin MP “Drejtimi i SME-ve”. GVJ i rekomandon IAL-së marrjen e masave të menjëhershme për rekrutim të PAE me grada shkencore për mbulimin e orëve mësimore në këtë program me qëllim respektimin e Ligjit 80/2015 - Neni 59, pika 6.
2. GVJ konstaton se bazuar në përgjigjet e GVB -së dhe në Nenin 15 të Rregullores së Departamentit të Menaxhimit nuk ishte Përgjegjës i Departamentit në rolin e

- Koordinatorit të këtij program, GVJ i rekomadon IAL-së ndarjen dhe përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave për çdo strukturë apo person përgjegjës në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi, përndryshe zbatimi i tyre do të vijojë të ndeshë situata të mos njohjes së detyrave dhe përgjegjësiave që ka secili dhe si rrjedhim mosmbarëvajtjen e këtij programi studimi në UAMD.
3. Anëtarët e GVJ-së konstatuan se: të gjithë syllabuset e depozituara në sistemin e ASCAL ishin dokumenta në word, pa firmën e titullarit/lektorit të lëndës dhe të përgjegjësit të departamentit; ka lëndë të cilat nuk kanë për titullar PAE me grada të kategorisë Profesor; ka module që kanë nevojë të përditësojnë literaturën bazë dhe rekomanduese duke qënë se shkon përtej harkut kohor të 5 viteve të fundit. GVJ rekomandon marrjen e masave të menjëhershme për adresimin e gjetjeve lidhur me syllabuset të cilat nuk janë sipas kërkesave dhe standardeve dhe si rrjedhim çënojnë cilësinë e mësimdhënies në këtë program mësimor.
  4. Nisur nga kriteri 8, në fushën I.3., ku shprehet se “Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.”, GVJ sjell në vëmendjen e IAL-së se duhet të marrë masa urgjente në mënyrë që të rritet numri i studentëve për këtë program. Në të kundërt, duke pasë parasysh ngjashmërinë në objektiva dhe kurrikul si edhe numrin e vogël të studentëve në hyrje dhe dalje në të dy programet e studimit MP, GVJ rekomandon bashkimin e këtij masteri me MP në “Menaxhim Biznes” i ofruar gjithashtu nga kjo njësi bazë brenda Fakultetit të Biznesit. Gjatë vizitës në IAL, mësuam se NJSBC e UAMD-së kishte sugjeruar të njëjtin mendim disa kohë më parë. Ose, GVJ rekomandon bashkimin e të dy MP-të në një të vetëm, duke krijuar 2 profile ku njeri prej tyre të jetë “Menaxhimi i SME-ve”.
  5. Rekomandohet të punohet për përmirësim të procesit për rritjen e cilësisë akademike të kandidatëve fitues gjatë procesit të rekrutimit të Personelit Akademik Efektiv të cilët më pas janë angazhuar në mësimdhënie në programin MP “Drejtimi i SME-ve” edhe pa zotëruar gradë shkencore.
  6. Në zbatim të kriterëve dhe kërkesave rregullatore dhe konstatimit të GVJ se të dhënat e raporteve të institucionit dhe të dhënat e përpunuar për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie nuk janë të publikuara online me qëllim që të gjithë aktorët të jenë të informuar; GVJ i rekomandon IAL-së marrjen e masave të menjëhershme për publikimin në webfaqen e UAMD-së të rezultateve të vlerësimit si edhe tërheqjen e vëmendjes së Komisionit për garantimin e standardeve dhe cilësisë së institucionit për mos zbatimin e kësaj kërkesë të dhënë në përmbushje të rekomandimit Nr.1 nga grupi i vlerësimit mbi



- akreditimin insitucional lidhur me raportet e institucionit dhe të dhënave të përpunuar për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.
7. GVJ rekomandon që Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të marrë masa të menjëhershme për të siguruar në vijimësi që KPGSCI (Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë së Institucionit) dhe NJSBC e quajtur edhe “Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë” të ushtrojnë të gjitha detyrat që ju ngarkon statuti i UAMD-së në Kreun VII të tij si edhe kuadri rregullator në fuqi duke qenë profesionist, transparentë dhe të pavarur, me qëllim për të garantuar cilësinë në mësimdhënie.
  8. GVJ i rekomandon IAL-së të mbaj në konsideratë kryerjen e një pune cilësore dhe evidenca të sakta nga GVB-të në plotësimin e çdo RVB-je që do të kërkohet në të ardhmen, duke garantuar transparencë dhe simetri informacioni.
  9. GVJ rekomandon se UAMD duhet të implementojë Sistemin e Menaxhimit të Informacionit edhe për stafin dhe studentët e këtij programi studimi pasi ai siguron akses në informacione dhe dokumenta si për stafin e UAMD-së edhe për studentët e këtij programi studimi.
  10. Rekomandohet përfshirja në kurrikul e lëndëve karakterizuese për ti mundësuar studentëve të thellohen specifikisht në problemet e menaxhimit të SME-ve si dhe për ti ofruar atyre shprehje të veçanta në fushën e drejtimit të SME-ve duke plotësuar dhe nevojat e tregut të punës, në nivel lokal e kombëtar.
  11. Rekomandohet që IAL të ndërmarë një studim tregu të mirëfilltë ku të analizohen nevojat e tregut të punës sot dhe identifikimin e atyre moduleve/lëndëve të reja që do të pasuronin kurrikulen e programit të studimit. Gërshetimi i këtyre nevojave me njohuritë profesionale do të mundesonin përgatitjen e specialistëve që i mungojnë tregut të punës sot. Kjo gjë do t’i jepte një avantazh konkures edhe vetë insitucionit në të ardhmen.
  12. Rekomandohet hartimi nga Institucioni i një plan-buxheti të detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond i vecantë për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line.
  13. GVJ rekomandon që stafi i pavarur dhe përfaqësues të studentëve të përfshihen për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.
  14. Rekomandohet që Institucioni të kryejë një analize të të dhënave të punesimit të studentëve pas diplomimit.
  15. Rekomandohet të pasurohet dhe të plotësohet logjistika IT dhe programet kompjuterike.
  16. GVJ i rekomandon IAL-së të ketë në Rregulloren e Rekrutimit të pasqyruara kriteret e përgjithshme për kategoritë asistent lektor, lektor dhe profesor. Këto kriteret të përfshijnë





notën mesatare të ciklit të parë dhe notën mesatare të ciklit të dytë të studimeve, profilin e studimit, shkollim dhe kualifikim të mëtejshëm, përvojën e punës në mësimdhënie, kualifikime brenda apo jashtë vendit, njohuri të gjuhëve të huaja, aktiviteti botues shkencor, etj., me qëllim që kriteret kryesore të mos ngelen për tu përcaktuar sipas rastit dhe të garantohet gjithmonë që njoftimet për vende pune dhe kriteret të jenë të publikuara dhe të aksesueshme në website të IAL-së.

17.Rekomandohet që vlerësimi i njohurive dhe dijeve me shkrim të bëhet në mënyrë anonime, sugjerohet që fletoret e provimeve të sekretohen.

18.Nga një evidentim qe GVJ i bëri planit mësimor të programit, MP në “Drejtimi i SME-ve” ka 60 kredite në total nga të cilat 26 fitohen në semestrin e parë, 18 në semestrin e dytë , 6 praktika profesionale dhe 10 mikroteza (*Evidenca: “Riorganizim i Programit MP në Drejtimi i SME-ve”*; “*Plani mësimor MP në Drejtimi i SME-ve*”). Rekomandohet që këto specifika të integrohen edhe në rregulloren e programit të studimit, duke e bërë atë më të personalizuar dhe detajuar.”



**Summary Conclusions of the External Evaluation Report, of the second cycle study program Professional Master in “Management of SME”, of the Higher Education Institution, University “Aleksandër Moisiu”, Durrës.**

**Strengths and Affirmations**

1. UAMD is maximally engaged in creating various forms of cooperation in function of all academic processes in the institution.
2. UAMD is strongly oriented towards student’s support in various forms from the moment of enrollment until their graduation.
3. The commitment of the leaders of the institution and the support offices that they put in function of the university, are an added value for the study program.
4. As in no other public HEI, UAMD has created very suitable environments and opportunities for performing the duties of the staff of this study program.

**Weaknesses**

1. Lack of discussions and analyzes on the workload of this study program has resulted in non-compliance of the quality and standards set for teaching to be performed only by EAPs who have scientific degrees for not less than 70% of the teaching load.
2. Duties and responsibilities for each structure or responsible person are not defined and in accordance with the legal criteria and regulatory requirements in force.
3. The syllabuses of the subjects of this study program, deposited in the QAAHE system did not meet the requirements according to the required criteria and standards.
4. The downward trend in the number of students enrolled in this study program continues.
5. Lack of academic quality of the winning candidates during the EAP recruiting process.
6. The reports of the institution and the processed data for quality assurance in teaching are not published, creating a lack of transparency and not all actors are informed.
7. Non-Compliance of the duties assigned by the statute of UAMD in Chapter VII as well as the applicable regulatory framework by the Standing Committee on Guaranteeing the Standards and Quality of the Institution and the IQAU.
8. Lack of transparency and information symmetry in completing the Self-Evaluation Report.
9. Lack of Information Management System for academic staff and students of this study program.



10. There is a lack of characteristic subjects in the curriculum of this study program, to enable students to deepen specifically in SME management problems and to provide them with special skills in the field of SME management by meeting the needs of the labor market, locally and nationally.
11. There is a lack of a proper market study to analyze the needs of the labor market today and the identification of those new modules / subjects that would enrich the curriculum of this study program. Combining these needs with professional knowledge would enable the training of specialists who are lacking in the labor market today. This would give a competitive advantage to the institution itself in the future.
12. There is a lack of a detailed budget plan with the relevant items for training support and a special fund for research / scientific activities for the professional development of academic staff, library expenses and enrichment of literature / access to online libraries.
13. The involvement of independent staff and student representatives to perform quality assurance functions with integrity and independence is lacking.
14. There is a lack of analysis of student employment data after graduation.
15. IT logistics and computer programs is poor and deficient.

## Recommendations

1. EEG concludes that the HEI does not conduct discussions and analyzes on the workload in this study program, resulting in non-compliance of the quality and standards set for teaching to be performed only by EAPs who have scientific degrees for not less than 70% of the teaching load, as well as to increase the quality of teaching, it is necessary to implement the Instruction No. 29, dated 12.09.2018 of MASR, as it is evidenced that almost all EAPs have performed additional classes of 200 teaching hours in the auditorium, in addition to other working hours for other commitments to HEIs. Also, for the academic year 2018-2019 for this study program, EEG notes that the category of EAP with scientific degrees covers only 47.2% of teaching hours; while EAPs that do not have a degree higher than the study cycle where they teach, cover 39.3% of the teaching hours. EEG concludes that HEI is not in accordance with Law 80/2015 - Article 59, point 6, which requires that EAP with scientific degrees covers not less than 70% of teaching hours in the Professional Master program "Management of SME". EEG recommends to HEIs to take immediate measures for the recruitment of EAP with scientific degrees to cover the teaching hours in this program in order to comply with Law 80/2015 - Article 59, point 6.
2. EEG finds that based on the responses of Self-Evaluation Group and Article 15 of the Regulation of the Department of Management, was not the Head of the Department in the



role of Coordinator of this program, EEG recommends to the HEI the division and clear definition of tasks and responsibilities for each structure or responsible person in accordance with the applicable legal and regulatory criteria and requirements, otherwise their implementation will continue to face situations of non-recognition of the duties and responsibilities that each person or structure has and consequently the failure to maintain this study program at UAMD.

3. EEG members finds that: all syllabuses deposited in the QAAHE system are documents in word, without the signature of the head / lecturer of the subject and the head of the department; there are subjects that do not have EAP title holders with the ranks of Professor category; there are modules that need to update the basic and recommended literature as it goes beyond the time frame of the last 5 years. The EEG recommends the Institution to take immediate measures to address the findings regarding the syllabuses which are not in line with the requirements and standards and therefore affect the quality of teaching in this study program.
4. Based on criterion 8, in field I.3., Which states that "Second cycle programs" Professional Master " can be opened temporarily in order to meet the needs of qualified personnel in a certain direction", EEG points out to the HEI that urgent measures must be taken in order to increase the number of students for this study program. On the contrary, given the similarity in objectives and curricula as well as the small number of students entering and exiting both Professional Masters study programs, EEG recommends merging this master's degree with the Professional Master program in "Business Management" also offered from this Basic Unit within the Faculty of Business. During the visit to the HEI, EEG learned that the UAMD IQAU had suggested the same opinion some time ago. Or, EEG recommends merging the two MPs into one, creating 2 profiles where one of them is "SME Management".
5. EEG recommends that there is room for improvement in terms of increasing the academic quality of winning candidates during the recruitment process of Effective Academic Personnel who are then engaged in teaching in the Professional Master program "Management of SME" without even possessing scientific degrees.
6. Pursuant to the regulatory criteria and requirements and the finding of the EEG that the data of the institution's reports and the processed data for quality assurance in teaching are not published online in order for all actors to be informed; The EEG recommends to the HEI to take immediate measures for the publication on the UAMD website of the evaluation results as well as draws the attention of the Commission for Guaranteeing the Standards and Quality of the institution for non-implementation of this request given in fulfillment of the



recommendation. No. 1 by the EEG on institutional accreditation regarding the reports of the institution and the processed data for quality assurance in teaching.

7. The EEG recommends that the Academic Senate and Administration Board take immediate action to ensure that the Standing Committee on Guaranteeing Institutional Standards and Quality Assurance and the IQAU, also called the "Directorate of Curricula and Quality Assurance", exercise all the tasks assigned to by the statute of UAMD in Chapter VII as well as the regulatory framework in force, being professional, transparent and independent, in order to guarantee the quality of teaching.
8. EEG recommends to the HEI to consider performing quality work and accurate evidences from Self Evaluation Groups in completing any Self Evaluation Report required in the future, guaranteeing transparency and symmetry of information.
9. EEG recommends that UAMD should implement the Information Management System for both the staff and students of this study program as it provides access to information and documents for both UAMD staff and students of this study program.
10. It is recommended the inclusion of characteristic subjects in the curriculum of the study program to enable students to deepen specifically in SME management problems and to provide them with special skills in the field of SME management by meeting the needs of the labor market, at local and national level.
11. The institution is recommended to undertake a proper market study to analyze the needs of the labor market today and identify those new modules / subjects that would enrich the curriculum of this study program. Combining these needs with professional knowledge would enable the training of specialists who are missing in the job market today. This would give a competitive advantage to the institution itself in the future.
12. The institution is recommended to draft a detailed budget plan with the relevant items for training support and a special fund for research / scientific activities for the professional development of academic staff, library costs and enrichment of literature / access to online libraries.
13. It is recommended the inclusion of independent staff and students representatives, to perform quality assurance functions with integrity and independence.
14. It is recommended the Institution to conduct an analysis of student's employment data after graduation.
15. It is recommended the enrichment and completion of IT logistics and computer programs.
16. The EEG recommends that the HEI in the Regulation on Recruitment should reflect the general criteria for the categories of assistant lecturer, lecturer and professor. These criteria should include the average grade of the first cycle and the average grade of the second cycle of studies, study profile, education and further qualification, work experience in teaching,





qualifications inside or outside the country, knowledge of foreign languages, publishing scientific activity, etc., in order for the main criteria not to remain to be determined as appropriate and to always guarantee that job vacancies and criteria are published and accessible on the HEI website.

17. It is recommended that the assessment of written knowledge to be done anonymously, it is suggested that exam notebooks to be secreted.
18. EEG evidenced that the curriculum of the study program Professional Master in "Management of SME" has 60 credits in total of which 26 are earned in the first semester, 18 in the second semester, 6 professional internships and 10 micro thesis (Evidence: "Reorganization of the PM Program in Management of SME "; " PM Curriculum in Management of SME "). It is recommended that these specifications to be integrated into the study program regulation as well, making it more personalized and detailed.



### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT</b>			<b>X</b>	
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>			<b>X</b>	
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>			<b>X</b>	
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE</b>		<b>X</b>		
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			<b>X</b>	

